

# INSTITUCIONET KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË NJË EMERGJENCË PUBLIKE

MJET REFERIMI



Ky raport është pjesë e përpjekjeve të ODIHR-it për t'iu përgjigjur sfidave ndaj të drejtave të njeriut të shkaktuara prej pandemisë së COVID-19 në mbarë OSBE-në

Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike  
dhe Të Drejtat e Njeriut (ODIHR)

Miodowa 10  
00-251 Warsaw  
Poland

Telefon: +48 22 520 06 00  
Faks: +48 22 520 0605  
Email: [office@odihhr.pl](mailto:office@odihhr.pl)  
osce.org/odihhr  
© OSCE/ODIHR 2020  
ISBN 978-3-903128-57-6

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret dhe të kopjohet lirisht për qëllime edukimi dhe do qëllim tjetër jotregtar, me kusht që në çdo riprodhim të paraqesë shprehimisht që burimi është OSBE/ODIHR.

Ky dokument është koordinuar nga ODIHR dhe është hartuar nga kryekonsulentët Sasa Jankovic, Susan Atkins dhe Dimitris Christopoulos. ODIHR falënderon edhe Sekretariatit e ENNHRI-së për kontributet e ofruara dhe gatishmërinë për të dhënë njohuritë e tyre, si edhe për lehtësimin e shkëmbimit të informacionit midis ODIHR-it dhe IKDNj-ve që janë pjesë e rrjetit të tyre (Armenia, Franca, Gjeorgjia, Moldavia, Sllovenia dhe Ukraina).

Dizenjoja nga "Homework"

## PASQYRA E LËNDËS

<b>HYRJE: QËLLIMI I MJETIT TË REFERIMIT</b> .....	4
<b>PJESA 1 - KONTEKSTI: PËRSHPEJTIMI I PUNËS SË IKDNJ-ve GJATË EMERGJENCAVE - SHEMBULLI I KRIZËS SHËNDETËSORE NGA COVID-19</b> .....	7
1.1. ROLI I IKDNJ-ve DHE PARAKUSHTET QË TË VAZHDOJNË DHE TË INTENSIFIKOJNË PUNËN E TYRE GJATË EMERGJENCAVE.....	7
1.2. ROLI GJITHNJË E MË I RËNDËSISHËM I IKDNJ-ve GJATË EMERGJENCAVE CIVILE .....	8
1.3. FOKUSI TE SEKTORI I SIGURISË.....	10
<b>PJESA 2: KONTRIBUT PRAKTIK PËR PUNËN E IKDNJ-ve GJATË EMERGJENCËS</b> .....	13
2.1. KALIMI NË GJENDJEN E EMERGJENCËS .....	13
2.2. SHPALOSJA E EMERGJENCËS CIVILE DHE KONSOLIDIMI .....	14
2.3. ZBUTJA, TRANCIZIONI DHE PERIUDHA PAS EMERGJENCËS.....	26
<b>3. PËRFUNDIM</b> .....	31

## HYRJE: QËLLIMI I MJETIT TË REFERIMIT

Gjendjet e emergjencës dallojnë nga disa faktorë: nga shkaqet (kërcënim ushtarak ose terrorist, kryengritje, fatkeqësi natyrore, sëmundje ngjitëse si COVID-19, ose ndonjë kërcënim tjetër ndaj vendit dhe jetës së popullatës) dhe nga reagimet e institucioneve qeverisëse. Varet nga natyra dhe konteksti i emergjencës se cilat të drejta të njeriut pezullohen apo kufizohen, në çfarë mase dhe për sa kohë<sup>1</sup>. Për sa kohë vetë shtetet dhe institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut (IKDNj-të) dallojnë mes tyre, atëherë edhe reagimet e IKDNj-ve në situata specifike janë të shumëllojshme.

Ky mjet referimi synon të ndihmojë IKDNj-të në ushtrimin e funksioneve të tyre gjatë kohëve të emergjencës civile dhe post-emergjencës, qofshin të shpallura zyrtarisht (si gjendje emergjence apo të jashtëzakonshme<sup>2</sup>, ose sipas një përcaktimi tjetër zyrtar), ose të imponuara *de facto*<sup>3</sup>. Mjeti nuk ofron një listë shteruese për masa që duhen marrë apo zgjidhje përfundimtare. Përkundrazi, synon të shërbejë si referencë, stimul apo frymëzim për masat që marrin IKDNj-të.

Mjeti është shkruar në kontekstin e pandemisë COVID-19, prandaj i referohet kësaj situatë krize shëndetësore. Njëkohësisht, ka për qëllim t'u vijë në ndihmë IKDNj-ve në çdo emergjencë, kur një situatë e jashtëzakonshme e shtyn Shtetin të kufizojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore që janë të garantuara.

Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut parashikojnë mundësinë që, vetëm në disa kushte strikte, të miratohen derogime (shmangie/përrjashtime) nga detyrimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në kohë emergjencash publike "që kërcënojnë jetën e një kombi".<sup>4</sup> Në të tilla rrethana të jashtëzakonshme, e drejta ndërkombëtare i lejon derogimet, por ende duhet t'u nënshtrohen parimeve kyçe të nevojës, proporcionalitetit, ligjshmërisë dhe mosdiskriminimit, si edhe duhet të kenë afat kohor.

Zotimet e OSBE-së parashikojnë derogime gjatë "gjendjes së emergjencës civile" e cila "justifikohet vetëm nga rrethanat më të jashtëzakonshme dhe të rënda".<sup>5</sup>

Klauzolat e derogimit kërkojnë përmbushjen e kushteve të përgjithshme nga Shteti që kërkon derogim, siç shtjellohet edhe në Dokumentet e OSBE-së në Kopenhagen (1990) dhe Moskë (1991):<sup>6</sup>

- Ekziston një situatë të jashtëzakonshme që paraqet kërcënim themelor, real dhe aktual ose i pashmangshëm për një vend;
- Emergjencia dhe derogimi kanë natyrë të përkohshme;

<sup>1</sup> Komisioneri i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut(OHCHR), "Masat e Emergjencës dhe COVID-19: Orientime", 27 prill 2020, [https://www.ohchr.org/Documents/Events/EmergencyMeasures\\_COVID19.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/Events/EmergencyMeasures_COVID19.pdf).

<sup>2</sup> Disa shtete bëjnë dallim mes gjendjes së emergjencës dhe situatës së emergjencës, ku dallimi kryesor është se gjendja e emergjencës zbatohet në mbarë vendin, kurse situata e emergjencës kufizohet në një bashki, qytet apo rajon të një shteti.

<sup>3</sup> "Imponuar *de facto*" i referohet ose aplikimit të normave kufizuese që kanë ekzistuar sipas ligjeve për shëndetin publik, luftimin e sëmundjeve ngjitëse, fatkeqësitë natyrore dhe të tjera, kundërtterrorizmin, etj., por nuk evokohen në kohë të zakonshme; ose miratimi i ndryshimeve në këto ligje me të njëjtin efekt; ose zbatimimi apo interpretimi i normave ekzistuese në mënyrë më strikte (përfshirë nxjerrjen nga ekzekutivi të dekreteve, direktivave apo udhëzimeve detyruese të cilat në praktikë rezultojnë në zbatim më rigoroz të ligjeve ekzistuese; ose në çfarëdo mënyre tjetër, por të gjitha pa shpallur zyrtarisht gjendjen e jashtëzakonshme apo gjendjen e emergjencës.

<sup>4</sup> Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, "Pakti Ndërkombëtar për Të Drejtat Civile dhe Politike" (ICCPR), 16 dhjetor 1996, neni 4, pika 1, <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx> dhe Këshilli i Evropës, "Konventa Evropiane për Të Drejtat e Njeriut" (KEDNJ, 12 nëntor, 1950, neni 15, pika 1, [https://www.echr.coe.int/Documents/Convention\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf).

<sup>5</sup> Shih: OSBE, "Dokumenti i Mbledhjes së Kopenhagenit të Konferencës për Dimensionin Njerëzor të OSBE-së" (Dokumenti i Kopenhagenit), 29 qershor 1990, pika 25, <https://www.osce.org/odihr/elections/14304>; dhe "Dokumenti i Mbledhjes së Moskës së Konferencës për Dimensionin Njerëzor të OSBE-së" (Dokumenti i Moskës), 3 tetor 1991, pika 28.1, <https://www.osce.org/odihr/elections/14310>.

<sup>6</sup> Po aty. Për më shumë mbi të drejtat e njeriut dhe derogimet, shih: ODIHR, "Zotimet për Dimensionin Njerëzor të OSBE-së dhe Reagimet e Shteteve ndaj Pandemisë Covid-19", 17 korrik 2020 <https://www.osce.org/odihr/human-rights-states-of-emergency-covid19>.

- Shteti plotëson disa kërkesa procedurale lidhur me deklarimin dhe shpalljen publike të derogimit, sipas përcaktimeve në ligj, si dhe informon zyrtarisht Zyrën e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe Të Drejtat e Njeriut (ODIHR), OKB-në dhe Këshillin Evropës;
- Masat deroguese bëhen të qarta dhe të aksesueshme për publikun;
- Duhet garanci dhe mekanizma mbikëqyrës, përfshirë rishikimin konstant të nevojës për të mbajtur gjendjen e emergjencës dhe çdo masë të marrë lidhur me të;
- Masat deroguese duhet të jenë rreptësisht të nevojshme dhe proporcionale për nevojat e situatës në aspektin kohor, gjeografik dhe material, pa përjashtuar disa të drejta të paderogueshme nga objekti i zbatimit;
- Masat nuk duhet të bien ndesh me detyrimet që lindin nga e drejta e ndërkombëtare, përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të drejtën ndërkombëtare të refugjatëve; dhe
- Masat deroguese nuk duhet të jenë diskriminuese në ligj dhe në praktikë.

Zotimet e OSBE-së shprehimisht deklarojnë se derogimet nuk mund të bëhen për "të drejta për të cilat nuk mund të ketë asnjë derogim". Sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të drejtat absolute nuk mund të pezullohen ose kufizohen në asnjë rrethanë, madje as në rast emergjence. Të drejtat absolute përfshijnë të drejtën kundër torturës dhe trajtimeve apo dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, të drejtën për të qenë i lirë nga skllavëria, të drejtën për të mos u burgosur për pamundësinë për të përmbushur një detyrim kontraktual dhe të drejtën e njohjes para ligjit. Këtu përfshihet edhe ndalimi i gjenocidit, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, ndalimin e funksionimit prapaveprues të ligjeve penale, ndalimin e privimit arbitrar të lirisë dhe të drejtën e kujtudo që privohet nga liria të bëjë padi para një gjykate për të ankimuar ligjshmërinë e masës së arrestit me burg, si edhe parimin e moskthimit (*non-refoulement*).<sup>7</sup> Gjatë shpalljes dhe menaxhimit të emergjencës, qeveritë kanë detyrimin të respektojnë këto kërkesa ligjore dhe të japin llogari për to.<sup>8</sup>

Zotimet e OSBE-së ofrojnë udhëzime posaçërisht për shpalljen e gjendjes së emergjencës. Dokumenti i Moskës rendit disa kërkesa dhe kushte për shpalljen e gjendjes së emergjencës, që duhet të bëhet "vetëm nga një organ i ligjshëm kushtetues" i mandatar për ta bërë këtë, por, kur shpalljen e bëjnë autoritetet ekzekutive, "vendimi duhet të shqyrtohet ose të kontrollohet nga ligjvënësi<sup>9</sup> brenda një kohe sa më të shkurtër". Gjithashtu, shpallja duhet të bëhet "zyrtarisht, publikisht dhe në përputhje me dispozitat e përcaktuara në ligj".<sup>10</sup>

IKDNj-të janë pjesë e kuadrit llogaridhënës në Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së.<sup>11</sup> Për shkak të mandateve të tyre, ato kanë detyrimin të jenë më vigjilente gjatë emergjencës: Vëzhgimi i Përgjithshëm 2.5 për Parimet lidhur me Statusin e Institucioneve Kombëtare (Parimet e Parisit) kërkon që në situata grushti shteti apo gjendje emergjence, IKDNj-të të veprojnë me "nivel të rritur vigjilence dhe pavarësie".<sup>12</sup> Ky detyrim merr edhe më shumë peshë kur kriza paralizon mekanizmat e tjerë mbikëqyrës, si parlamentin apo gjyqësorin. Pra, në një situatë emergjence publike, IKDNj-të kanë

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> Shih: Komiteti i OKBS-së për Të Drejtat e Njeriut, "Deklarata për Derogimet nga Pakti lidhur me Pandeminë COVID-19", 24 prill 2020, <https://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/CCPR/COVIDstatementEN.pdf>.

<sup>9</sup> OSBE, Dokumenti i Moskës, pika 28.3, *op. cit.*, shënimi 5.

<sup>10</sup> Po aty. Për më shumë mbi të drejtat e njeriut dhe derogimet, shih: ODIHR, "Zotimet për Dimensionin Njerëzor të OSBE-së dhe Reagimet e Shteteve ndaj Pandemisë Covid-19", 17 korrik 2020

<sup>11</sup> Në vitin 1990 në Kopenhagen, Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u zotuan "të lehtësojnë ngritjen dhe forcimin e institucioneve kombëtare të pavarura në fushën e të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës". "Shtetet pjesëmarrëse zotohen edhe se, për shkeljet e dyshuara të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, mjetet juridike efektive përfshijnë (...) të drejtën e individit që të kërkojë dhe të marrë ndihmë nga të tjerët për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe të ndihmojë të tjerët në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore", Dokumenti i Kopenhagenit i OSBE-së, *op. cit.*, shënimi 5.

<sup>12</sup> Aleanca Globale e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (GANHRI), "Vëzhgime të Përgjithshme të Nënkomitetit për Akreditimin, 21 shkurt 2018,

[https://nhri.ohchr.org/EN/AboutUs/GANHRIAccreditation/General%20Observations%201/EN\\_GeneralObservations\\_Revisions\\_adopted\\_21.02.2018\\_vf.pdf](https://nhri.ohchr.org/EN/AboutUs/GANHRIAccreditation/General%20Observations%201/EN_GeneralObservations_Revisions_adopted_21.02.2018_vf.pdf).

në pozitën ideale për të bërë dallimin mes kufizimeve të ligjshme të të drejtave të njeriut dhe shkeljes së të drejtave të njeriut.

Emergjencat vlejné edhe për të testuar<sup>13</sup> pavarësinë, legjitimitetin, besueshmërinë dhe efikasitetin e IKDNj-ve sipas Parimeve të Parisit. Madje, në kohë të tilla, kapacitetet institucionale të IKDNj-së që të përmbushë detyrat dhe të realizojë përgjegjësitë vlerësohet kundrejt elementeve të tjerë kyçë të Parimeve të Parisit, si p.sh. pluralizmi dhe pasja e një mandati të gjerë dhe funksione të caktuara; nga ana tjetër, shërbejnë për të vlerësuar nëse IKDNj-së i janë akorduar kompetenca dhe burime adekuate.

Edhe pse emergjencat janë të përkohshme, mund të kenë ndikim afatgjatë te të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Pandemia COVID-19 është padyshim rasti tipik. Vetëm pak muaj pas shpërthimit të pandemisë, pasojat e para ishin rritja e papunësisë në nivele të paprecedentë, ulja e pagave të punëtorëve dhe rënie e përgjithshme e shërbimeve shëndetësore. Ndikim negativ ka pasur jo vetëm te të drejtat ekonomike dhe sociale, por janë prekur edhe të drejtat civile dhe politike, si rezultat i kufizimit të lëvizjes, karantinës dhe regjimit të izolimit, mbylljes së kufijve, shtyrjes së zgjedhjeve, rritjes së mbikëqyrjes dhe masave të tjera. Më shumë është rënduar situata negative e personave që jetojnë në rrethana vulnerabël, si në realitete konflikti apo post-konflikti, apo që vuanin nga marginalizimi dhe diskriminimi.<sup>14</sup>

Por, pasojat negative të politikave dhe masave të miratuara në përgjigje të një krize nuk duhet të konsiderohen si të pashmangshme dhe ndikimi i tyre duhet adresuar. Parimet ndërsektoriale të të drejtave të njeriut si mosdiskriminimi, barazia, pjesëmarrja, transparenca dhe llogaridhënia kanë peshë specifike në përballimin e çdo krize.<sup>15</sup>

Qeveritë gëzojnë marzh diskrecioni në zgjedhjen e mjeteve për mbrojtjen e të drejtave në kohëra shtrëngimi shoqëror, të cilat përshtaten më mirë me rrethanat e tyre. Sidoqoftë, ligji për të drejtat e njeriut përcakton disa vija të kuqe që nuk duhen kaluar nga politikat që miratohen dhe zbatohen nga qeveria, ndërsa IKDNj-të kanë përgjegjësinë të mbikëqyrin që këto viza të kuqe/kufij të mos shkelen.

Kërcënimet ndaj demokracisë dhe të drejtave të njeriut janë po aq të rënda sa kërcënimet ndaj jetës, prandaj që të tria kërkojnë mbrojtjen maksimale. Për këtë arsye, ky mjet thekson nevojën që IKDNj-të të bëjnë një punë të shkëlqyer, me qëllim kapërcimin e krizës me dëmin minimal ndaj shoqërisë dhe individëve.

Për lehtësi përdorimi, ky mjet ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë shpjegon rolin vendimtar që IKDNj-të kanë në kohë emergjence publike dhe parakushtet që të vazhdojnë të punojnë me efektivitet. Pjesa e dytë ofron këshilla praktike për masat që mund të merren nga IKDNj-të përgjatë një emergjence publike kur masat zbatohen me konsistencë, si edhe pas mbarimit të gjendjes së emergjencës. Për secilën fazë, ky dokument ofron ide për angazhim konkret të IKDNj-ve, duke pasur parasysh rolin e tyre si garantues – si për çështjet sistemike dhe rastet individuale – në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës, në kontestimin e keqadministrit dhe në ofrimin e shërbimeve sipas mandatit të tyre.

<sup>13</sup> Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, " Parimet lidhur me Statusin e Institucioneve Kombëtare (Parimet e Parisit)", 20 dhjetor 1993, <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/statusofnationalinstitutions.aspx>.

<sup>14</sup> ODIHR, "Zotimet për Dimensionin Njerëzor të OSBE-së dhe Reagimet e Shteteve ndaj Pandemisë Covid-19", *op. cit.*, shënimi 6.  
15 ICCPR, neni 2.1, 19, 21, 22.1 dhe 25, *op. cit.*, shënimi 3; Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, "Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore" (ICESCR), 16 dhjetor 1966, neni 2.2, <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cescr.aspx>;  
Kombet e Bashkuara, "Karta e Kombeve të Bashkuara";, 26 qershor 1945, Preambula, <https://www.un.org/en/charter-united-nations>;  
Kombet e Bashkuara, "Deklarata Universale e Të Drejtave të Njeriut" (UDHR), 10 dhjetor 1948, Preambula, <https://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights>.

# PJESA 1 - KONTEKSTI: PËRSHPEJTIMI I PUNËS SË IKDNJ-ve GJATË EMERGJENCAVE - SHEMBULLI I KRIZËS SHËNDETËSORE NGA COVID-19

## 1.1. ROLI I IKDNJ-ve DHE PARAKUSHTET QË TË VAZHDOJNË DHE TË INTENSIFIKOJNË PUNËN E TYRE GJATË EMERGJENCAVE

Gjendjet e emergjencës paraqesin sfida për IKDNj-të në ushtrimin e rolit të tyre, nga problemet e vogla në punën e përditshme deri tek gërryerja sistematike e elementëve thelbësorë të prerogativave të tyre të mishëruara në Parimet e Parisit, si p.sh. mandati dhe kompetencat, autonomia nga qeveria, pavarësia, pluralizmi, dhe që duhet të kenë kompetenca hetimore dhe burime adekuatë.<sup>16</sup>

Gjatë një emergjence, puna kryesore që bëjnë IKDNj-të mund të sfidohet në mënyra që pengojnë rolin e tyre dhe ua cenojnë pavarësinë, përfshirë edhe buxhetet e tyre (p.sh. masa e financimit dhe autonomia operationale mbi alokimin e tij); lirinë e pjesëtarëve dhe personelit të IKDNj-ve që të lëvizin lirshëm në ushtrim të funksioneve të tyre; të drejtën për akses të pakufizuar në informacion, zyrtarë apo vende specifike si ambientet e privimit të lirisë; gatishmërinë e interlokutorëve të ndryshëm që të takohen me ta; dhe aksesin e qytetarëve dhe joqytetarëve të IKDNj-të, përfshirë mundësinë për të paraqitur ankesa, sipas rastit.

Përderisa IKDNj-ja ndan barrën e krizës me shoqërinë dhe institucionet e tjera, i takon asaj (dhe parlamentit, sipas nevojës) të vendosin se si të adresojnë saktësisht krizat sipas mandatit të vet; mund të paraqiten kërcënime për pavarësinë dhe kapacitetin e tyre operacional, të cilat janë në thelb të Parimeve të Parisit. Për të parandaluar ose kundërvepruar ndaj çdo kërcënimi ndaj pavarësisë dhe kapaciteteve të veta, ndërkohë që sigurohet të bazojë veprimet brenda mandatit dhe standardeve të të drejtave të njeriut, IKDNj-ja mund të marrë këto masa:

- Kundërshton zyrtarisht dhe publikisht çdo propozim apo masë (qoftë edhe financiare) që minon pavarësinë dhe kapacitetin e vet për të ushtruar mandatin institucional;
- Harton dhe miraton në mënyrë proaktive rregulla dhe modalitete për udhëtimet e shërbimet të pjesëtarëve dhe personelit të IKDNj-së brenda vendit, si edhe për lëvizjet e nevojshme për kryerjen e funksioneve monitoruese. Në këtë kontekst, IKDNj-ja duhet të mbajë parasysh kufizimet e përgjithshme që ekzistojnë gjatë gjendjes së emergjencës, si dhe të sigurohen që policia dhe shërbimet e tjera të ngarkuara me vënien në zbatim të këtyre kufizimeve të njoftohen paraprakisht dhe të njohin vërtetimet që IKDNj-ja lëshon për udhëtimet dhe lëvizjet për qëllime pune;
- Paraqet kërkesa pranë subjekteve përkatëse për pajisje mbrojtëse dhe trajnim menjëherë për personelin përkatës të IKDNj-së, nëse këto pajisje mbrojtëse dhe/ose trajnimi për çdo lloj lëvizje pune në rrethanat e reja (përfshirë edhe udhëtimet e punës) janë të detyrueshme por jo të disponueshme në shkallë të gjerë;
- Garanton përmes kontakteve me median dhe kanalet e tjera të informimit, që të gjithë personat brenda juridiksioni të Shtetit të informohen mbi aktivitetet e IKDNj-së dhe si të kontaktojnë me të;
- Reagon fuqishëm zyrtarisht dhe, nëse nevojitet edhe publikisht, nëse një institucion nën mbikëqyrjen e IKDNj-së nuk respekton plotësisht një hetim apo ndërhyrje parandaluese, refuzon të japë informacion apo akses, ose nuk bashkëpunon sipas ligjit;
- Ndan me organizatat, institucionet dhe shoqatat ndërkombëtare, si Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (UNHCHR), Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, ODIHR, Aleanca Globale e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (GANHRI) dhe Rrjetin Evropian të Institucioneve të

<sup>16</sup> Parimet e Parisit, *op. cit.*, shënimi 13.

Të Drejtave të Njeriut (ENNHRI), çdo informacion për sulme të rënda ndaj mandatit, pavarësisht, kapacitetet dhe/ose aftësisë operacionale<sup>17</sup> të IKDNj-së; dhe

- Zhvillon vazhdimisht kapacitetet dhe të mund të pajtojnë ekspertë të jashtëm në çdo fushë, përfshirë sigurinë, teknologjinë e informacionit dhe shëndetin, dhe mjetet e veta të transportit, pajisjet mbrojtëse, etj.

## 1.2. ROLI GJITHNJË E MË I RËNDËSISHËM I IKDNJ-ve GJATË EMERGJENCAVE CIVILE

Në një demokraci, ligjet dhe politikat janë legjitime në masën në të cilën ato justifikohen publikisht dhe pranohen përgjithësisht nga komuniteti. Justifikimi dhe besimi publik tek autoritetet është rezultat i debatit të lirë dhe konstruktiv, i cili mund të mungojë ose të kufizohet gjatë periudhave të emergjencës; të dyja janë shumë të nevojshme gjatë fillimit të procesit dhe në arritjen e rezultateve. Në një gjendje emergjence, koha dhe efektiviteti kanë rëndësi madhore. Autoritetet ekzekutive duhet të jenë në gjendje të veprojnë shpejt dhe me efikasitet, në mënyrë që të adresojnë një kërcënim të caktuar. Situata të tilla shpesh karakterizohen nga miratimi i procedurave të thjeshtuara për vendimmarrjen, tkurje të transparencës, zvogëlim të konsultimeve dhe arsytetimeve, si edhe një tendosje të përgjithshme të sistemit të kontrollit dhe balancave (*checks and balances*).

Sidoqoftë, të gjitha masat e jashtëzakonshme ekzekutive duhet të kenë afat rigoroz dhe të rishikohen rregullisht nga parlamenti, për t'u siguruar që masat janë ende të nevojshme dhe proporcionale. Parlamenti duhet të mbikëqyrë veprimet ekzekutive në intervale të arsyeshme dhe duhet të ndërhyjë mbi baza *ad hoc* që të modifikojë apo të rrezojë vendime të ekzekutivit, kur është e nevojshme.<sup>18</sup>

Masat e emergjencës të miratuara për adresimin e pandemisë COVID-19 prishën mbikëqyrjen parlamentare në mjaft vende. Parlamentet në disa vende ushtruan thjesht kontroll formal mbi ekzekutivin, ndërsa në pak vende pushuan së funksionuari plotësisht. Gjendjet e emergjencës, ndalimi i lëvizjes dhe karantina gjatë pandemisë, krijuan sfida të mëdha në funksionimin e gjykatave dhe aksesin në to. Në shumicën e Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, pandemia rezultoi në mbyllje (të pjesshme) të gjykatave dhe në pezullim të proceseve, përveç çështjeve urgjente. Edhe kur gjykatat qëndruan të hapura në parim, shpesh punuan me kapacitet të kufizuar.<sup>19</sup>

Emergjenca mund të zvogëlojë aftësinë e mekanizmave të ndryshëm nga IKDNj-të për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe mund të dobësojë kuadrin normal për mbikëqyrjen dhe llogaridhënien.<sup>20</sup> Për shembull, mbajtja e zgjedhjeve dhe referendumeve mund të jetë problematike, pasi mundësitë për të bërë fushatë kufizohen jashtëzakonisht në kohë krizash.<sup>21</sup> Kjo mund të ushqejë mosbesimin midis individëve, jeta e të cilëve pëson goditje të fortë, veçanërisht pasi perceptohet një zvogëlim i kërcënimit real apo kur ndikimi i masave të qeverisë ndihen gjithnjë e më shumë.

Ndarja dhe shpërndarja e kompetencave, si edhe ruajtja e sistemit të kontrollit dhe balancave ndaj masave të ekzekutivit do të jetë një sfidë madhore gjatë periudhës së emergjencës dhe post-emergjencës. Siç u vërejt me pandeminë COVID-19, gjatë dhe pas karantinave.

IKDNj-të ofruan hapësirë dialogu për organizatat e shoqërisë civile (OShC) dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm, çka mund të rezultojë jetike për konsultimin dhe transparencën. IKDNj-të munden që brenda mandatit të tyre, të kërkojnë arsyet e vendimeve të ekzekutivit në një periudhë kur organet mbikëqyrëse mund të jenë të heshtura.

<sup>17</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Komisioneri i Lartë i OKB-së për Të Drejtat e Njeriut, *UNDP-OHCHR Mjetet e Bashkëpunimit me Institucionet Kombëtare për Të Drejtat e Njeriut*, (Nju Jork, Gjenevë: Kombet e Bashkuara, 2010), <https://www.ohchr.org/Documents/Countries/NHRI/1950-UNDP-UHCHR-Toolkit-LR.pdf>.

<sup>18</sup> Kombet e Bashkuara, "COVID-19 dhe Të Drejtat e Njeriut: Ne e Përballojmë së Bashku", prill 2020, [https://www.un.org/victimsofterrorism/sites/www.un.org.victimsofterrorism/files/un\\_-\\_human\\_rights\\_and\\_covid\\_april\\_2020.pdf](https://www.un.org/victimsofterrorism/sites/www.un.org.victimsofterrorism/files/un_-_human_rights_and_covid_april_2020.pdf).

<sup>19</sup> ODIHR, "Zotimet për Dimensionin Njerëzor të OSBE-së dhe Reagimet e Shteteve ndaj Pandemisë Covid-19", *op. cit.*, shënimi 6.

<sup>20</sup> Shih Rrjeti Evropian i Organizatave Kombëtare për Të Drejtat e Njeriut (ENNHRI), "COVID-19 dhe Të Drejtat e Njeriut", <http://ennhri.org/covid-19/>.

<sup>21</sup> ODIHR, "Zotimet për Dimensionin Njerëzor të OSBE-së dhe Reagimet e Shteteve ndaj Pandemisë Covid-19", *op. cit.*, shënimi 6.



Ky angazhim i IKDNj-ve forcon substancën demokratike të një shteti, duke u ofruar të gjithë individëve mundësinë të kuptojnë shkaqet e vendimeve të ekzekutivit. Ky është një aset i veçantë në kohë pasigurie kombëtare (dhe globale).

Gjendjet e emergjencës lidhen drejtpërdrejt me qeverisjen, por paraqesin sfida edhe për sigurinë njerëzore<sup>22</sup>. Në rrethana të tilla mund të merret një shumëllojshmëri masash, si p.sh. masa të përqendruara nga qeverisja vendore dhe qendrore lidhur me sigurimet shoqërore dhe ndihmën ekonomike; nga sektori privat, duke ofruar shërbime financiare, akomodim dhe shërbime TI; dhe nga organizatat e shëndetësisë, arsimit dhe sektorit vullnetar. Çdo mosfunksionim në këto fusha mund të rezultojë në hendek në ofrimin e shërbimesh, ku mund të bien kategoritë vulnerabel dhe që mund të shfrytëzohet nga të tjerët.

Këto janë disa prej arsyeve pse IKDNj-të kanë rol veçanërisht të rëndësishëm për të luajtur, siç kërkon edhe Vëzhgimi i Përgjithshëm 2.5 i Parimeve të Parisit.<sup>23</sup> Roli në gjendje emergjence duhet të jetë më proaktiv dhe më i zëshëm se zakonisht, që të japë alarmin kur nevojitet, të mbushë boshllëqet në mbikëqyrje dhe të garantojë llogaridhënien e institucioneve shtetërore.

Për shkak të strukturës, statusit dhe rolit specifik në kohë emergjence publike, IKDNj-ja mund të marrë këto masa:

- Vepron si urë mes individëve dhe shtetit, duke ngritur pranë autoriteteve përgjegjëse çështje që shqetësojnë qytetarët dhe joqytetarët;
- Vepron si urë mes shoqërisë civile dhe shtetit, duke krijuar platforma për shoqërinë civile dhe qeverinë ku të debatohet për masat e emergjencës dhe, nëse kjo nuk është e mundur, duke ngritur çështje që shqetësojnë shoqërinë civile dhe duke përcjellë idetë e tyre, sipas rastit;
- Angazhohet me parlamentin dhe organet shtetërore në hartimin e legjislacionit dhe politikave, si edhe në dhënien pa vonesë të komenteve ligjore;
- Merr masa parandaluese dhe mbrojtëse lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të të gjithë individëve brenda juridiksionit të shtetit;
- Garanton mbrojtje ndaj masave diskriminuese;
- Mbikëqyr veprimet (ose mosveprimet) konkrete të ekzekutivit, si dhe vepron si garant sistematik i funksionimit të shtetit të së drejtës; dhe
- Merr rol aktiv në vlerësimin e politikave dhe buxheteve sipas standardeve të të drejtave të njeriut.

Në këtë drejtim, IKDNj-të mund të monitorojnë e të kërkojnë arsye dhe të tërheqin vëmendjen e publikut te:

- Numrin dhe përmbajtjen e akteve ligjore që miraton qeveria të cilat zëvendësojnë ligjet në fuqi, si edhe masën deri ku ato bien në kundërshtim me standardet e të drejtave të njeriut dhe ligjet e tjera në fuqi (duke cenuar konsistencën e sistemit ligjor dhe rrjedhimisht edhe të shtetit të së drejtës);
- Ligjet e reja apo dekretet për të cilat nuk është dhënë informacion në kohën e duhur dhe në mënyrë të kuptueshme për të gjithë individët;
- Keqpërdorimi i mundshëm i krizës, p.sh. për fushatë politike nga partitë qeverisëse;

<sup>22</sup> Rezoluta 66/290 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së përcakton se "siguria njerëzore është një përjasje për të ndihmuar Shtetet Anëtare në evidentimin dhe adresimin e sfidave të mëdha dhe ndërsektoriale të mbijetesës, jetesës dhe dinjitetit të popujve të tyre". Ajo bën thirrje për "përgjigje tërësore, kontekstuale dhe parandaluese me në qendër qytetarin, të cilat forcojnë mbrojtjen dhe fuqizimin e të gjithë njerëzve", <https://www.un.org/humansecurity/what-is-human-security/>.

<sup>23</sup> GANHRI, "Vëzhgime të Përgjithshme të Nënkomitetit për Akreditimin", Vëzhgim i Përgjithshëm 2.5, *op. cit.*, shënimi 12.

- Masa në të cilën qeveritë ndjekin propozimet dhe këshillat e komiteteve të ekspertëve në strukturat e menaxhimit të krizave, si edhe ekzistenca e mekanizmave pjesëmarrës për trajtimin e krizave;
- Masa në të cilën ekspertët e të gjitha specializimeve përkatëse, sidomos ekspertët për të drejtat e njeriut, përfshihen apo përjashtohen nga komitetet këshillimore;
- Masa në të cilën anëtarësia e komiteteve të tilla pasqyron diversitetin e shoqërisë, përfshirë aspektet e gjinisë, moshës dhe aftësisë së kufizuar, por edhe përkatësinë etnike, fenë apo besimin;
- Masën në të cilën ruhet pluralizmi mediatik, mënyra se si ekzekutivi i përgjigjet kërkesave të medias, nëse medias po i mbyllet goja apo po vihet nën presion më të madh, si dhe nëse opozita ka akses në media me qëllim që të shprehë pikëpamjet e veta;
- Masa në të cilën janë zhvilluar debatet parlamentare (edhe ato që mbahen përmes teknologjive dixhitale) lidhur me vendime madhore që kanë implikime në respektimin e të drejtave të njeriut, nëse ka pasur mungesë gjithëpërfshirjeje, llogaridhënieje dhe konsiderate për ndikimin te grupet vulnerabël;
- Shkeljet e mundshme të jetës private individuale pa bazë ligjore të duhur dhe në mospajtim me kushtet e nevojës, proporcionalitetit dhe miratimit paraprak gjyqësor apo tjetër nga autoriteti përkatës;
- Paanësia dhe neutraliteti politik i policisë, shërbimeve të sigurisë dhe ushtrisë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre në kuadrin e gjendjes së emergjencës;
- Përdorimi apo keqpërdorimi i kompetencave nga policia, shërbimet e sigurisë dhe ushtria, në shkelje të kompetencave ligjore dhe funksioneve të tyre;
- Ligjshmëria dhe përshtatshmëria e metodave që sektori i sigurisë përdor për të vënë në zbatim regjimin e emergjencës (sidomos përdorimi i forcës dhe përpunimi i të dhënave personale); dhe
- Nëse ndihma shtetërore po shpërndahet me barazi, drejtësi dhe pa diskriminim, pa paragjykim mbi bazë race, ngjyre, seksi, gjuhe, feje, opinionin politik apo tjetër, prejardhjeje kombëtare apo shoqërore, prone, lindjes apo statusi tjetër, si edhe mbi bazë përkatësie politike të autoriteteve vendore dhe rajonale.

### 1.3. FOKUSI TE SEKTORI I SIGURISË

Gjendja e emergjencës ndërhyr në funksionimin normal të shoqërisë, sidomos në aspektet e garantimit të sigurisë dhe mbrojtjen për të gjitha personat brenda juridiksionit të shtetit. Emergjencia civile lidhur me krizën shëndetësore nga COVID-19 krijoi sfida shumëfishe dhe sprova të jashtëzakonshme për sektorin e sigurisë në Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, p.sh. lidhur me këto aspekte:

- Lirimi i personave të privuar nga liria si masë kundër infektimit, ndërkohë që zbatohet regjimi i karantinës;
- Angazhimi në rritje i policisë dhe madje i ushtrisë në zbatimin e karantinës; disa shtete kanë pasur ushtarë me armë automatike që patrollojnë rrugëve, ose kanë ndaluar lëvizjet mes rajoneve në vend;
- Caktimi i detyrave të jashtëzakonshme forcave të armatosura, p.sh. transporti i personave të vdekur drejt ambienteve përkatëse; apo shërbimet sekrete që sigurojnë pajisje mjekësore të zakonshme (si ventilatorët).

Situata të tilla rrisin rrezikun e përdorimit të tepruar të forcës, tejkalimin e kompetencave ligjore dhe shkelje apo abuzime të tjera të sektorit të sigurisë. Kjo mund të rezultojë në shkelje të të drejtave të njeriut dhe/ose devijim nga roli i përshtatshëm që duhet të luajnë forcat e sigurisë në një demokraci.<sup>24</sup>

Gjatë krizës së COVID-19, pati rritje eksponenciale të përdorimit të teknologjive të reja - si aplikacionet e gjurmimit, dronët, pajisjet e identifikimit të fytyrës dhe imazheve termike, përpunimi i të dhënave personale në shkallë të gjerë dhe inteligjenca artificiale – nga strukturat e sigurisë për mbikëqyrjen dhe garantimin e zbatimit të masave të emergjencës, të cilat nxitën një sërë shqetësimesh, si për shembull:<sup>25</sup>

- Nëse përdorimi i aplikacioneve të gjurmimit duhet të jetë i detyrueshëm apo vullnetar;
- Si garantohet ruajtja e duhur e të dhënave personale, si dhe deri në çfarë mase duhet të lejohet akses në këto të dhëna për shërbimet sekrete dhe të sigurisë;
- Nëse përdorimi i teknologjive të tilla për të zbatuar karantinën individuale apo gjeografike është proporcionale me rrezikun (me rrezikun e përhapjes së sëmundjes, në këtë rast).

Shqetësimet e publikut të gjerë dhe të ekspertëve variojnë nga çështjet e jetës private deri te ato etike - madje edhe ekzistenciale - në lidhje me të ardhmen e shoqërive. Aktiviteti i shtuar i ofruesve të sigurisë kërkon garanci të rritura të kontrollit civil demokratik, llogaridhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut nga personeli i forcave të sigurisë. IKDNj-të duhet të kenë kapacitetin për t'u marrë me këto dhe të tjera çështje të ngjashme.

Emergjencat mund të çojnë edhe në efekte afatgjata më pak të dukshme, por potencialisht të dëmshme, të tilla si militarizimi dhe sigurizimi (prania e tepërt e forcave të sigurisë) të vazhdueshme për shoqëritë dhe hapësirën publike. Emergjencat shpesh kërkojnë vendime të pazakonta në angazhimin e institucioneve/strukturave të sigurisë. Ruajtja e mbikëqyrjes civile demokratike mbi ofruesit e sigurisë është e rëndësishme për të garantuar që ato t'u kthehen detyrave dhe përgjegjësive normale sapo emergjenca të mbarojë, pa mbajtur ende kompetencat shtesë që kanë fituar gjatë krizës – tundim ky që meriton vigjilencë konstante për t'u frenuar.<sup>26</sup>

Gjithashtu, para marrjes së vendimeve për angazhimin e forcave të sigurisë, mund të mbahen konsultime gjithëpërfshirëse, sepse kjo lejon hapësirë të madhe për punën parandaluese dhe mbrojtëse për të drejtat e njeriut, si edhe lejon IKDNj-të luajnë rolin që u takon në mbikëqyrjen demokratike të forcave të armatosura. Kur nevojitet, IKDNj-të duhet të bëjnë të mundur që ofruesit e sigurisë të kuptojnë nevojën e mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe dobisë që vetë institucionet e sektorit të sigurisë kanë nga kjo mbikëqyrje.

## TË DREJTAT E NJERIUT TË PERSONELIT TË SEKTORIT TË SIGURISË

Të drejtat e njeriut të qytetarëve në uniformë dhe të personelit të sigurisë pa uniformë, përfshirë sigurinë dhe mbrojtjen e tyre, vihen në rrezik gjatë gjendjes së emergjencës. Në varësi të llojit të emergjencës, "fronti i parë" i përbërimit përbëhet nga shumica e personelit të sektorit të sigurisë dhe personeli mjekësor. Këtu përfshihen ushtarakët, policia, roja kufitare, organet e mbrojtjes civile, personeli i burgjeve dhe shërbimet sekrete. Edhe përfshirja e personelit të sektorit privat mund të rritet.

Emergjenca kërkon që për këtë personel të ketë rritje të dislokimit dhe marrjen e roleve jashtë detyrave të zakonshme.<sup>27</sup> Kjo situatë mund të rritë rreziqet për personelin e sigurisë, por edhe për personat të cilëve u shërbejnë

<sup>24</sup> ODIHR, "Orientime për Përdorimin e Forcës nga Personeli Ligjzbatues në Kohën e Emergjencës së COVID-19", 22 prill 2020, fq. 3, <https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Executions/HumanRightsDispatch1.pdf>.

<sup>25</sup> Shih: Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), "Gjurmimi dhe Detektimi i COVID: Mbrojtja e Jetës Private dhe Të Dhënave gjatë Përdorimit të Aplikacioneve dhe Biometrikës", 23 prill 2020, <https://www.oecd.org/coronavirus/policy-responses/tracking-and-tracing-covid-protecting-privacy-and-data-while-using-apps-and-biometrics-8f394636/>; Kombet e Bashkuara, "COVID-19 dhe Të Drejtat e Njeriut: Ne e Përballojmë së Bashku", *op. cit.*, shënimi 18, fq. 16.

<sup>26</sup> Qendra e Gjenezës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë (DCAF), *Ndikimi i COVID-19 te Qeverisja e Sektorit të Sigurisë*, (Gjenevë, DCAF, 2020), <https://www.dcaf.ch/impact-covid-19-security-sector-governance>.

<sup>27</sup> DCAF, "Siguria dhe Përgjigja e Reformës në Drejtësi ndaj Krizës së Covid-19", <https://issat.dcaf.ch/Learn/SSR-in-Practice/Thematics-in-Practice/Security-and-Justice-Reform-Response-to-Covid-19-Crisis>.

---

dhe/ose mbrojnë. Kështu, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore të personelit të sigurisë duhet të jetë një shqetësim i fuqishëm për IKDNj-të.

## PJESA 2: KONTRIBUT PRAKTIK PËR PUNËN E IKDNJ-ve GJATË EMERGJENCËS

### 2.1. KALIMI NË GJENDJEN E EMERGJENCËS

Fillimi i gjendjes së emergjencës mund të marrë forma të ndryshme dhe, në disa raste, gjendjet e emergjencës imponohen *de facto*.<sup>28</sup>

Me afrimin e krizës dhe nisur nga gjasat e shpalljes së gjendjes së emergjencës, një takim këshillimor mes institucioneve me tagrat për të shpallur gjendjen e jashtëzakonshme dhe IKDNj-së përkatëse do të ishte skenari i duhur që i përshtatet rolin këshillimor dhe parandalues të IKDNj-së, përveç funksionit monitorues.

Gjatë kësaj faze, IKDNj-ja duhet të mbajë parasysht si më poshtë:

- Pranon ftesën e autoritetit përgjegjës për të diskutuar mbi nevojën e shpalljes së gjendjes së emergjencës dhe çdo kufizim korrespondues lidhur me të drejtat e njeriut që propozohen ose, mundësisht, inicion një takim nëse vendimi për gjendjen e emergjencës duket se po mbruhet, por autoriteti përgjegjës nuk e ka thirrur këtë takim;
- Inicion një takim të tillë, nëse gjendja e emergjencës është vendosur jozyrtarisht ose imponohet *de facto*.
- Krijon komitetin këshillimor të emergjencës për vetë IKDNj-në, duke përfshirë mundësisht ekspertë të pavarur dhe përfaqësues të shoqërisë civile; dhe
- Nëse mungojnë kërkesat ligjore për organizmin e autorizuar që deklaron/shpall gjendjen e emergjencës që të marrë opinionin paraprak nga IKDNj-ja për derogimet e pritshme të të drejtave të njeriut, IKDNj-ja i drejton një kërkesë që të merren masa për ndryshime normative për këtë qëllim sapo emergjenca të mbarojë.

Lidhur me rolin për garantimin e shtetit të së drejtës, IKDNj-ja duhet të mbajë parasysht si më poshtë:

- Analizon nëse vendimi për gjendjen e emergjencës është marrë nga një autoritet përgjegjës kushtetues, sipas një procedure të parashikuar me ligj dhe për arsye të ligjshme, në përputhje të plotë me garantitë dhe standardet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;
- Sigurohet që vendimi për gjendjen e emergjencës përmban derogime për të drejta të caktuara, ato të drejta të jenë të derogueshme (nuk duhet të jenë të drejta dhe liri të paderogueshme që garantohen nga instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe kushtetuta e vendit);
- Verifikon nëse derogimet i janë nënshtruar procedurave ligjore të njoftimit, siç kërkohet nga dispozitatat përkatëse të kushtetutës apo instrumenteve ndërkombëtare; dhe
- Nëse gjendja e emergjencës është shpallur zyrtarisht dhe nuk mund t'i nënshtrohet shqyrtimit parlamentar apo gjyqësor për të dhënë arsyetim se si rrethanat e ndryshuara justifikojnë shtimin e kompetencave të qeverisë apo miratimin prej saj të akteve nënligjore kufizuese, si edhe ndryshimet në interpretimin dhe/ose kufizimin e të drejtave dhe lirive të caktuara, çka rezultojnë në regjim më kufizues sesa në rrethana normale.<sup>29</sup>

Nëse konsideratat më lart ngjallin shkaqe për shqetësim, IKDNj-ja mund të marrë këto masa:

<sup>28</sup> ODIHR, Zotimet për Dimensionin Njerëzor të OSBE-së dhe Reagimet e Shteteve ndaj Pandemisë Covid-19", op cit., shënimi 6, fq.25; shih edhe: Shërbimi Kërkimor i Parlamentit Evropian (EPRS), "Gjendjet e Emergjencës në Përgjigje të Krizës së Koronavirusit: Situata në disa Shtete Anëtare", qershor 2020, [https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document.html?reference=EPRS\\_BRI\(2020\)651972](https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document.html?reference=EPRS_BRI(2020)651972).

<sup>29</sup> Disa shtete, brenda tre muajsh nga fillimi i krizës së Covid-19, miratuan mbi 100 akte normative apo ndryshime në aktet ekzistuese, pa shpallur zyrtarisht gjendjen e emergjencës.

- I drejtohet autoritetit që ka marrë një vendim të diskutueshëm ku i kërkon arsyet e vendimit dhe/ose të propozojnë mjetet për korrigjimin e situatës;
- Konteston vendimin para një gjykata kushtetuese apo mekanizmi tjetër kombëtar me mandatin që të mbrojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë, në vendet ku ky veprim lejohet dhe brenda mandatit të IKDNj-së; dhe/ose
- Paraqet opinione *amicus curie* lidhur me snjë ankim/padi të bërë tashmë nga një tjetër palë, që konteston kushtetutshmërinë dhe/ose ligjshmërinë e vendimit;

Kujdes shtesë duhet treguar kur informohet publike për veprimet më lart, me qëllim që publiku të kuptojë qartë pozicionin e IKDNj-së.

## 2.2. SHPALOSJA E EMERGJENCËS CIVILE DHE KONSOLIDIMI

Kur vendimi se si të adresohet emergjenca apo nëse duhen vendosur kufizime për liritë themelore dhe të drejtat e njeriut për shkak të krizës bëhet i pashmangshëm ose hyn në fuqi, IKDNj-ja fokusohet në këto aspekte:

- Sigurohet që ka kapacitetet dhe burimet e nevojshme për të funksionuar në mënyrë të pavarur dhe me efektivitet gjatë emergjencës;
- Kryen një vlerësim rreziqesh për ndikimin e emergjencës dhe masave të qeverisë sidomos te grupet vulnerabël;
- Përdor fuqimisht kapacitetet e burimet për të përmbushur mandatin me nivel më të lartë vigjilence dhe pavarësie.

Ruajtja e kapaciteteve dhe realizimi i vlerësimit i mundëson IKDNj-së të vendosë çfarë veprimesh të ndërmarrë për të përmbushur mandatin e vet në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe të sigurohet se po vepron drejt.

### RUAJTJA DHE PËRDORIMI I KAPACITETEVE TË IKDNJ-SË PËR TË VEPRUAR ME EFEKTIVITET

Shpesh është sfidë për IKDNj-të që të ruajnë dhe të forcojnë kapacitetet për të përballuar sfidat në rritje ndaj të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, siç kërkojnë Parimet e Parisit. Sfidë mund të jetë edhe presioni i brendshëm apo i jashtëm për pakësim burimesh, p.sh. shkurtim buxheti apo kur personeli i IKDNj-së preket nga emergjenca (si me Covid-19).

Gjatë gjendjes së emergjencës, roli i IKDNj-së mund të jetë vendimtar për një sërë arsyesh, si:

- Mandati unik dhe i gjerë që përfshin role si mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut; mbikëqyrja demokratike e sektorit të sigurisë; rolet këshillimore, *quasi*-gjyqësore, ndërmjetëse, rregullatore dhe edukative; forcimi i shtetit të së drejtës; dhe mbështetja e palëve të dëmtuara, sinjalizuesve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut;<sup>30</sup>
- Shpesh kanë personel më të larmishëm, përfshirë gra, persona me aftësi të kufizuara, pjesëtarë të pakicave etnike dhe fetare, LGBTI dhe grupe të nënpërfaqësuar, krahasuar me institucionet apo organizatat e tjera;
- Aftësia për mbledhje, analizim dhe përhapje informacioni nga/te shumë burime qeveritare dhe joqeveritare. Nga ana tjetër, gjatë emergjencës, burimet e informacionit të qeverisë mund të jenë të përqendruara dhe të kufizuara, dhe informacioni priret të merret nga burime të kufizuara - kryesisht nga ekspertët dhe niveli drejtues;
- Janë në pozitën e duhur për të evidentuar grupet e reja vulnerabël apo ndikime të paparashikuara/disavanazhuese të kufizimeve dhe masave të qeverisë te këto grupe apo individë;

<sup>30</sup> Jo të gjitha IKDNj-të kanë të gjitha rolet e renditura.

- Distanca nga vendimmarrja urgjente mund të kontribuojë në objektivitet më të madh. Autoritetet e ngarkuara me menaxhimin e një krize mund të kenë pak kohë për analizë ose reflektim; madje, e kanë të vështirë të shqyrtojnë dhe të vlerësojnë informacionet që u vijnë nga një mori burimesh. IKDNj-ja ka aftësinë të analizojë tendencat dhe të paraqesë evidenca konkrete - veçanërisht për ndikimin te grupet vulnerabël të njohura apo të reja, çka e bën ndërhyrjen e IKDNj-së autoritare dhe të besueshme;
- Aftësia e sofistikimit të detajeve. IKDNj-të mund të bëjnë ndërhyrje taktike që synojnë zbutjen e pasojave në planin afatshkurtër, d.m.th. lehtësimin e dëmit apo padrejtësisë gjatë emergjencës;
- Aftësia strategjike. IKDNj-të mund të fokusohen te ndikimet afatmesme dhe afatgjata të krizës dhe përgjigjeve, për të minimizuar efektet e padëshirueshme;
- Aksesin në rrjete ndërkombëtare. IKDNj-të përfitojnë nga shkëmbimi i informacionit përmes kufijve shtetërorë, p.sh. me IKDNj-të e shteteve fqinje apo organizatat ndërkombëtare që merren me të drejtat e njeriut;
- Influenca e gjerë dhe e fuqishme. IKDNj-të mund të arrijnë në çdo cep të vendit dhe të dëgjohen në nivel ndërkombëtar. Për shkak të mandatit, kanë akses të shpejtë në media dhe vëmendje të posaçme të kuvendit. IKDNj-ja ka mjetet për të ndikuar: me kapacitetet e duhura dhe vullnetin për t'i vënë në punë, IKDNj-ja bën ndryshimin.

IKDNj-ja mund të përgatitet dhe të ndihmojë aktorët kyçë të përgatiten më mirë për përballimin e krizës, p.sh.:

- Sigurohet që kanalet e komunikimit me aktorët kyçë, përfshirë qeverinë, parlamentin, masmedian, shoqërinë civile dhe juristët, të jenë solide dhe të mobilizohen shpejt. Për shembull:
  - T'i ftojnë në procese konsultimi periodik mbi krizën dhe përgjigjet;
  - Të paraprijnë organizimin e komunikimit gjatë emergjencës, përfshirë përdorimin e teknologjive të reja, medias sociale apo aktivizimit të rrjeteve informale mes personelit nën mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e IKDNj-së;
- Rishikon databazat e veta dhe kapacitetet e mbledhjes së të dhënave dhe analitike përkundër rreziqeve kryesore të identifikuar. IKDNj-ja mund të garantojë ndarje të të dhënave sipas gjinisë, moshës dhe përkatësisë etnike (nëse e lejon legjislacioni i brendshëm), që të kryhen analiza të përshtatshme dhe të merren masat korrigjuese të duhura;
- Ndërton apo përforcon kapacitetet e nevojshme për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave/informacionit;
- Vlerëson ndikimin e emergjencës te personeli i IKDNj-së dhe nivelet e personelit;
- Garanton mirëqenien dhe sigurinë e personelit të vet;
- Harton plane (edhe politika, sipas rastit) për të ruajtur shërbimet e IKDNj-së për publikun (nisur nga rritja e pritshme e kërkesës dhe ndikimit potencial të emergjencës te vetë personeli i IKDNj-së). Politika të tilla mund të përfshijnë punën në distancë apo modalitete të arsyeshme që i mundësojnë personelit me aftësi të kufizuara të vazhdojnë punën edhe gjatë rrethanave të reja;
- Rishikon planet, politikat dhe buxhetet nga këndvështrimi gjinor, si pjesë e përpjekjeve për integrim gjinor, si dhe duke pasur parasysh elementët e tjerë tërësorë si raca, përkatësia etnike, feja apo besimi, aftësia, mosha, punësimi, statusi i emigrimit, vendndodhja dhe faktorë të tjerë.

## KAPACITETI PËR MARRJEN DHE TRAJTIMIN E ANKESAVE

Nëse një IKDNj ka kapacitet *quasi*-gjyqësor, është thelbësore të vazhdojë të presë ankuesit individualë dhe ushtrimin e këtij funksioni.<sup>31</sup> Për të qenë e arritshme nga grupet e nënprivileguara apo të marginalizuara që mund të kenë vështirësi për të shkuar te zyra qendrore në kryeqytet apo të paraqesin ankesë me mjete në distancë, si edhe nga ata që jetojnë në zona të nënzhvilluara apo periferike, IKDNj-ja duhet të jetë gjithnjë e më e pranishme në terren, madje edhe në zonat e largëta. Prania në terren është e nevojshme për të ardhur në dijeni të ngjarjeve të cilat duhen hetuar kryesisht, nëse mandati i IKDNj-së e lejon.

## REALIZIMI I VLERËSIMIT

Në momentin kur shqyrtohet legjislacioni për emergjencën apo e shumta kur gjendja e emergjencës shpallet ose fillon *de facto*, IKDNj-ja duhet të shohë mundësinë e realizimit të një vlerësimi rreziku për evidentuar kërcënimet e mundshme ndaj të drejtave të njeriut (përfshirë te grupet vulnerabël të njohura) dhe të evidentojë grupe të tjera që janë ose mund të bëhen vulnerabël për shkak të emergjencës dhe/ose masave shtetërore për përballimin e emergjencës.

Vlerësimi i rrezikut për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe ndikimit të mundshëm të masave është i rëndësishëm, sepse politikat shtetërore fokusohen pashmangshmërisht në popullatën e gjerë – sidomos në fillim të krizës – dhe masat mbrojtëse janë të njëjta për të gjithë individët fillimisht. Por, kjo rrezikon të thellojë pabarazitë ekzistuese. Për më tepër, emergjenca civile mund të prekë grupe që nuk perceptohen si vulnerabël sipas kritereve të zakonshme. Roli i IKDNj-së është që të mos e lejojë të ndodhë, apo, ta ndërpresë nëse ka ndodhur tashmë. Me zbatimin e masave të emergjencës, mund të shfaqen papritur grupe të reja vulnerabël apo vulnerabilitete të reja mes grupeve të njohura. Për shembull, me krizën shëndetësore nga Covid-19, edhe pse të moshuarit (që janë më shumë gra) preken më lehtë nga virusi, Covid-19 shkaktoi më shumë vdekje te burrat sesa te gratë. Në disa shtete, ka pasur më shumë vdekje nga virusi ndër pjesëtarët e pakicave. Pabarazitë afatgjata sistemike shëndetësore dhe sociale bëjnë që grupet e pakicave etnike të jenë më në rrezik infektimi nga COVID-19 apo të sëmuren rëndë, pavarësisht moshës.<sup>32</sup>

Vlerësimi i rrezikut është një mjet efikas për IKDNj-të që të mbledhin informacionin e nevojshëm për të evidentuar kërcënimet ndaj të drejtave të njeriut gjatë një situatë emergjence, me qëllim që të marrin vendime nëse duhen marrë masa dhe, nëse po, të përcaktojnë prioritetet.

IKDNj-të janë vlerë e shtuar, sepse shohim rreziqet nga optika e të drejtave të njeriut. Prandaj, ka gjasa të dallojnë rreziqe që të tjerëve u kanë shpëtuar. Për shembull, gjatë krizës shëndetësore nga COVID-19, disa IKDNj në rajonin e OSBE-së, si rezultat i monitorimit, arritën të kontestojnë propozime për të prioritzuar kujdesin intensiv për personat nën moshën 70 vjeç, në mungesë të ndonjë sëmundjeje mjekësore apo faktorëve të tjerë që lidhen me sëmundshmërinë, si mbipesha.

Parimisht, vendimi për t'i refuzuar kujdesin intensiv një grupi ndryshon nga gjykimi klinik mbi probabilitetin e suksesit apo dëmit që të këtij kujdesi te një individ duke pasur parasysh moshë, sëmundjet, etj. Shqetësime të ngjashme janë ngritur gjatë pandemisë COVID-19 ku janë marrë vendime pa u konsultuar me pacientin apo familjen - për sa u përket pacientëve me aftësi të kufizuar nxënieje.

Dokumenti i Moskës e njeh barazinë gjinore si gur themeli për sigurinë dhe demokracinë në rajonin e OSBE-së. Në këtë drejtim, IKDNj-të duhet të mbajnë vigjilencën lart për rreziqet dhe shenjat e rritjes së dhunës me bazë gjinore.<sup>33</sup> Orientimet për dhunën me bazë gjinore jepen në një pjesë të posaçme më poshtë.

<sup>31</sup> Shih OHCHR, Institucionet Kombëtare për Të Drejtat e Njeriut: Historia, Parimet, Rolet dhe Përgjegjësitë (Nju Jork dhe Gjenevë: Kombet e Bashkuara, 2010), fq. 43, [https://www.ohchr.org/Documents/Publications/PTS-4Rev1-NHRI\\_en.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/Publications/PTS-4Rev1-NHRI_en.pdf). Disa IKDNj mund të kenë kompetenca *quasi*-gjyqësore, d.m.th. funksione që i lejojnë të marrin ankesa individuale.

<sup>32</sup> ODIHR, "Zotimet për Dimensionin Njerëzor të OSBE-së dhe Reagimet e Shteteve ndaj Pandemisë Covid-19", *op. cit.*, shënimi 6

<sup>33</sup> "Dhuna me bazë gjinore" është dëmi që i shkaktohet një personi (grua apo burrë) si rezultat i pabarazive të fuqisë që vetë bazohen në role gjinore. Por nuk është thjesht dhunë ndaj grave, sepse për shkak të pabarazive gjinore, gratë janë më shpesh objektivi i kësaj dhune. Edhe pasojat mund të jenë më të rënda te gratë. Dhuna me bazë gjinore mund të ndodhë në një familje apo kontekst familjar, në komunitet apo të shkaktohet ose të tolerohet nga shteti. Dhuna me bazë gjinore përfshin, ndër të tjera, edhe dhunën fizike dhe seksuale, si edhe veprimet që shkaktojnë dëmtim psikologjik, përfshirë kërcënimet për shkaktim dhune fizike apo seksuale si edhe abuzimin emocional apo financiar. Dhunë me bazë gjinore është edhe dhuna me shkaqe seksuale. Në situatë emergjence, veçanërisht vulnerabël mund të jenë pjesëtarët e komunitetit LGBTI.



---

Vlerësimi i rrezikut duhet të vlerësojë edhe rreziqet që vijnë nga dislokimi i shërbimeve të sigurisë, si në kuptimin e rreziqeve për gëzimin e gjerë të të drejtave të njeriut nga njëra anë, edhe të të drejtave dhe rreziqeve të vetë personelit të sigurisë. Orientimet për sektorin e sigurisë jepen në një pjesë të posaçme më poshtë.

Kur kryen vlerësimin e rrezikut, IKDNj-ja duhet të ketë parasysh këto aspekte:

- Identifikon rreziqet e mundshme për individët dhe grupet që mund të gjenden në situata vulnerabiliteti, p.sh., në ambientet e privimit të lirisë, (burgjet, qendrat e paraburgimit të emigrantëve, ambientet e sigurimit të detyrueshëm, qendrat e paraburgimit për të miturit, hotelet dhe ambiente të ngjashme të ideuara për izolim),<sup>34</sup> personat me aftësi të kufizuara (fizike, mendore dhe nxënieje), grupet e pakicave (pakicat raciale, etnike, fetare, gjuhësore dhe popujt indigjenë), gratë, fëmijët, personat LGBTI, të moshuarit, emigrantët, refugjatët, të shpërngulurit e brendshëm, azilkërkuesit ose grupe të tjera në rrezik (të pastrehët, njerëzit me probleme të abuzimit me substancat, ata në varfëri dhe të papunët, familjet me një prind, etj.);
- Konsultohet me të gjithë aktorët relevantë, veçanërisht me mekanizmin kombëtar për parandalimin e torturës dhe trajtimeve ose ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore dhe poshtëruese, nëse kjo nuk është tashmë pjesë e mandatit të IKDNj-së;
- Kryen një analizë me bazë gjinore për rreziqet që shkaktohen prej emergjencës dhe masave të qeverisë ndaj emergjencës, me qëllim që të identifikojë rreziqe të veçanta për gratë, p.sh., për shkak të shtatzënisë, lindjes së fëmijës, dhunës me bazë gjinore (veçanërisht dhunës në familje, si ishte rasti gjatë pandemisë COVID-19), të ardhurave, segregimit në punë, përgjegjësiive familjare dhe moshës, si dhe rreziqe të veçanta për burrat, p.sh., personat e dëmtuar nga dhuna e bandave apo e rrugës, normat e rritura të sëmundshmërisë apo normat e ulura të kapacitetit përballues të shërbimeve shëndetësore;
- Identifikon çdo grup tjetër vulnerabël që rezulton nën rrezik gjatë kësaj faze të emergjencës, p.sh. punonjësit "jetikë" kundër COVID-19 (ata në zinxhirin e furnizimit me ushqim, transporti, financat dhe administrata publike, si edhe punonjësit e shëndetësisë dhe sigurisë); personat që varen nga transporti publik, punëtorët emigrantë që jetojnë në bujtina, personat që kanë frikë nga dhuna në shtëpitë e tyre si gratë, fëmijët ose të moshuarit, personat me nevoja të veçanta arsimore, dhe ata me aftësi të kufizuara të nxënies apo të tjera që mund të kenë vështirësi të kuptojnë mesazhet kryesore të qeverisë në lidhje me masat emergjente dhe t'i aksesojnë këto të fundit;
- Përcakton rreziqet e veçanta për grupet vulnerabël të njohura dhe të evidentuara rishtazi si rezultat i emergjencës apo i masave qeveritare për përbalimin e emergjencës. Për shembull, gjatë krizës COVID-19, ekzistonte rreziku që, për shkak të mbylljes së shkollave, autoritetet që të humbnin nga fokusi fëmijët e identifikuar si në rrezik abuzimi seksual ose tjetër; të burgosurit ose personat e privuar nga liria në rrezik infektimi dhe abuzimi për shkak të ndalimit të vizitave të familjarëve, OShC-të, avokatët, etj.; punonjësit shëndetësorë dhe të kujdesit në spitale, institucionet e kujdesit apo shtëpitë e të moshuarve ku mungojnë pajisje mbrojtëse personale;
- Mban në konsideratë çështje specifike dhe rreziqe në lidhje me dislokimin dhe përdorimin e personelit të sigurisë, sidomos të policisë dhe forcave të armatosura, p.sh., përdorimi i tepruar i forcës, rritja e përhapjes së infeksionit ndër personelin e angazhuar, si dhe rritja e ngarkesës mbi shëndetin mendor. Rreziqet e tjera mund të përfshijnë perceptimin e masave të tepërta të sigurisë (*sigurizimi*) në shoqëri dhe hapësirë publike dhe frikën që kjo mund të provokojë, përfshirë ndjesinë e pasigurisë që shkakton prania e personelit të sigurisë nëpër rrugë; dhe
- I bën thirrje qeverisë për një plan veprimi që mbështet këto kategori që preken veçanërisht dhe janë vulnerabël ndaj masave të emergjencës që ndërmerren shteti (p.sh. në rast izolimi) dhe IKDNj-ja të japë këshilla mbi këto masa.

<sup>34</sup> Një analizë mund të bëhet për natyrën e të ashtuquajturit "vetizolim" (disa qeveri gjatë COVID-19 urdhëruan disa kategori qytetarësh p.sh. të kthyerit nga jashtë shtetit pa simptoma infektimi që të izolohehen në shtëpi për një periudhë të caktuar, pastaj monitorohen që ta zbatojnë urdhrin, ndërsa ata që e shkelën u ndoqën penalisht). Në këto rrethana, shtëpia mund të ngjajë si "vend privimi të lirisë" dhe mund të duhet të plotësojë disa standarde ndërkombëtare për të cilat shteti duhet të jetë përgjegjës.

## DHUNA ME BAZË GJINORE

Dhuna me bazë gjinore i referohet dëmit që pëson personi si rezultat i pabarazive të fuqisë, që vetë bazohen në rolet gjinore. Për shkak se dhuna me bazë gjinore ka të bëjë me pabarazitë (e perceptuara ose reale) të pushtetit, çdo situatë që heq garancitë kundër abuzimit ose rrit fuqinë e abuzuesit potencial, rrit rrezikun ose nivelet e një dhune të tillë.<sup>35</sup> Gjendja e emergjencës që prish balancat e jetesës normale mund të prishë edhe funksionimin efektiv të këtyre garancive.

Prandaj, kufizimet në vizitat e familjeve, miqve dhe OShC-ve, si dhe në kontaktin ballë për ballë me përfaqësuesit ligjorë, vendosin personat e privuar nga liria dhe që mbahen në ambiente sigurimi, burgje, qendra paraburgimi, spitale psikiatrike apo të shëndetit mendor, apo institucione të tjera, në rrezik të rritur ndaj dhunës me bazë gjinore. Këto rreziqe mund të rëndohen kur ka mungesë rojash femërore dhe/ose shoqëruesesh (p.sh., për shkak të shëndetit ose përgjegjësive të kujdesit) që zëvendësohen me meshkuj pa garanci shtesë. Mungesat e personelit mund të rrisin edhe rrezikun e abuzimit nga të burgosurit e tjerë. Rreziqe të ngjashme mund të lindin në institucionet *de facto* të mbyllura, d.m.th., ata që nuk janë ligjrisht të privuar nga liria, por *de facto* nuk mundin të dalin nga strehimi komunal dhe janë të izoluar (nuk u lejohen vizita). Këto mund të përfshihen shtëpitë e kujdesit rezidencial (për të moshuarit dhe ata me aftësi të kufizuara fizike ose intelektuale), kampet e emigrantëve dhe refugjatëve, bujtinat për të pastrehët apo azilkërkuesit si e dhe personelin e anijeve kroçere.

Edhe pse më pak e dukshme, prapë gjendja e emergjencës rrit rrezikun e dhunës me bazë gjinore në shtëpi apo konteste të tjera familjare. Gjatë pandemisë Covid-19, urdhrat që u kërkonin njerëzve të qëndronin në shtëpi perceptoheshin - dhe nganjëherë quheshin - si urdhra "për të qëndruar në një vend të sigurt". Por, për shumë njerëz dhe veçanërisht gratë dhe fëmijët, shtëpia mund të jetë një vend rreziku, pasi siguria vjen nga bashkëveprimi me botën e jashtme, familjen, miqtë, policinë dhe gjykatat, nga aksesit në shërbimet mjekësore, komunitare dhe sociale, si dhe nga aksesit në strehëzat e dhunës në familje.

Në mbarë rajonin e OSBE-së, raportohet një rritje drastike e rasteve të dhunës në familje dhe e kërkesave për shërbime mbështetëse, përfshirë strehimin.<sup>36</sup> Në disa raste, dëmtimi i referimit dhe i masave mbrojtëse, e ndërthurur me masat e izolimit, rezultoi në një rritje të dokumentuar të femicidit.<sup>37</sup> OKB-ja e ka quajtur "pandemi hije"<sup>38</sup> këtë rritje drastike të dhunës në familje ndaj grave. Gjatë pandemisë shëndetësore, shumë qeveri nuk morën parasysh ndikimin e masave të izolimit dhe se regjimet e izolimit mund të çojnë në rritje të dhunës në shtëpi. Njoftimet publike të mëvonshme se largimi nga shtëpia për t'i shpëtuar dhunës nuk përbën shkelje të urdhrat të izolimit patën fare pak efekt, sidomos kur personat që largoheshin (kryesisht gra) nuk kishin ku të shkonin, nuk mund të mbështeteshin te mbrojtja e policisë apo gjykatave, apo nuk mund të merrnin shërbime shëndetësore/mjekësore - përfshirë ato gjinekologjike, për shkak të përçarjes së shkaktuar nga pandemia. Dhuna ndaj fëmijëve ose të moshuarve u dokumentua më pak gjatë pandemisë, krahasuar me dhunën ndaj grave prej partnerit intim; megjithatë IKDNj-të kanë rol të rëndësishëm që të garantojnë se, në gjendje emergjence, çdokush të ketë akses në një vend të sigurt nëse shtëpia e tyre nuk është më e sigurt.

IKDNj-ja duhet ta përfshijnë dhunën me bazë gjinore në një vlerësimi rreziku, duke pasur parasysh këta faktorë:

- Rreziku i dhunës me bazë gjinore rritet ndjeshëm kur ekzistojnë kufizime për të dalë nga shtëpia, që kufizojnë ose ndalojnë kontaktet fizike me familjen, miqtë, mjekun e familjes, punëdhënësit, mësuesit, etj. Shtëpia nuk është vend e sigurt për të gjithë;

<sup>35</sup> ODIHR, *Parandalimi dhe Adresimi i Dhunës Seksuale dhe Dhunës me Bazë Gjinore në Ambientet e Privimit të Lirisë*, (ODIHR: Varshavë, 2019), fq. 21, <https://www.osce.org/odihr/427448>.

<sup>36</sup> ODIHR, "Zotimet për Dimensionin Njerëzor të OSBE-së dhe Reagimet e Shteteve ndaj Pandemisë Covid-19", *op. cit.*, shënimi 6, fq. 138. Raportohet edhe rritje e dhunës në internet, si përndjekja, bullizmi, ngacmimi seksual dhe trollimi seksual, të cilat gjatë një situatë izolimi e rrisin vulnerabilitetin e personit në shtëpinë e vet.

<sup>37</sup> OHCHR, "Deklaratë e Grupit të Punës së OKB-së për Diskriminimit ndaj Grave dhe Vajzave – Përgjigjet ndaj COVID-19 nuk duhet të shpërfillin Gratë dhe Vajzat", <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25808&LangID=E>.

<sup>38</sup> UN Women, "Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave: Pandemia Hije", Deklaratë nga Phumzile Mlambo-Ngcuka, Drejtore Ekzekutive e UN Women, 6 prill 2020, <https://www.unwomen.org/en/news/stories/2020/4/statement-ed-phumzile-violence-against-women-during-pandemic>.

- Izolimi rrit fuqinë dhe kontrollin e abuzuesit, p.sh., duke kontrolluar aksesin në celular ose në Internet, ose duke larguar personat që mund parandalojnë incidentet e abuzimit;
- Kufizimet e lëvizjes; kushtet e jetesës gjatë mbylljes apo vetizolimit, shqetësimet financiare dhe të tjera; dhe/ose humbja e punësimit mund të rritë zemërimin, frustrimin dhe nevojën e abuzuesit për të ushtruar kontroll, gjë që rrit rrezikun e dhunës ndaj personave brenda rrezes së kontrollit të abuzuesit në shtëpi;
- Kufizimet e lëvizjes, sidomos mbyllja e shkollave, mund të rrisin rrezikun e dhunës seksuale dhe shfrytëzimin e fëmijëve dhe të rinjve, përfshirë abuzimin në internet;
- Gjendja e emergjencës mund të ndërpresë apo të kufizojë shërbimet juridike, mjekësore, komunitare apo bamirëse, çka rrit vulnerabilitetin dhe pafuqinë e personave të rrezikuar nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore;
- Gjendja e emergjencës mund të rritë rrezikun e dhunës me bazë gjinore nga aktorët shtetërorë, përfshirë personelin e sigurisë që mund t'u jepen kompetenca shtesë dhe kanë prani dhe ndërveprim të rritur me pjesëtarët e publikut;
- Emergjencia mund t'ua vështirësojë palëve të dëmtuara apo dëshmitarëve denoncimin e abuzimit dhe aksesin në shërbimet mbrojtëse normale, përfshirë shërbimet mjekësore dhe policore dhe masat gjyqësore;
- Rritja e rreziqeve nga dhuna me bazë gjinore në ambientet e privimit të lirisë. Kufizimet e vizitave rrisin izolimin dhe vulnerabilitetin e personave në rrezik. Edhe kur lejohet komunikim në distancë me përfaqësuesit ligjorë apo IKDNj-të, personat e rrezikuar nga dhuna me bazë gjinore mund të mos jenë në gjendje të denoncojnë abuzimin për shkak të pranisë së padukshme të abuzuesit, kërcënimeve, pengesave praktike apo faktorëve të tjerë specifikë të personit të dëmtuar, p.sh. moshë, gjuha apo aftësia e kufizuar e nxënies;<sup>39</sup> dhe
- Gjendja e emergjencës thëllon pabarazitë ekzistuese, përfshirë në punësim, siguri financiare, shëndetësi dhe akses në shërbime, që kanë ndikim më afatgjatë dhe potencialin për të rritur vulnerabilitetin ndaj dhunës me bazë gjinore.

Po kaq vëmendje i duhet kushtuar edhe personave të rrezikuar nga forma të tjera gjuhe urrejtjeje, p.sh., mbi bazën e përkatësisë etnike, origjinës (etnike dhe kombëtare), fesë dhe/ose aftësisë së kufizuar. Në situata emergjence, mund të shtohet presioni për të gjetur një fajtor për kufizimet në jetën e përditshme – çka rrjedhimisht rrit gjuhën e urrejtjes.<sup>40</sup>

## **VLERËSIMI I RREZIKUT NË SEKTORIN E SIGURISË**

Vlerësimi i rrezikut duhet të përfshijë çdo shqetësim dhe rrezik që lind nga emergjencia apo nga masat e qeverisë për përbalimin e saj, lidhur me dislokimin dhe përdorimin e personelit të sigurisë, sidomos të policisë dhe forcave të armatosura.

IKDNj-ja duhet të ketë parasysh monitorimin dhe ngritjen e problematikave si më poshtë:

- Nëse personeli i sigurisë ka trajnimin, pajisjet ose burime të tjera që u duhen për të përmbushur funksionet e tyre gjatë emergjencës, p.sh. nëse njësitë ushtarake janë trajnuar për kryerjen e misionëve civile;

<sup>39</sup> Një sërë IKDNj-sh kanë identifikuar vulnerabilitete dhe/ose kanë dhënë rekomandime në këtë drejtim, p.sh.: të moshuarit që nuk njohin median sociale/teknologjitë e reja, kanë mungesë aksesit në celular TI, etj.; të burgosurit me aftësi të kufizuar nxënies – që përbëjnë përqindje të lartë në popullatën e burgjeve – mund të mos kenë aftësinë të kuptojnë proceset gjyqësore që zhvillohen në mjete TI në distancë.

<sup>40</sup> *Human Rights Pulse*, “Cunami i Urrejtjes”: Pandemia e Gjuhës së Urrejtjes e Covid-19”, faqja e internetit e *Human Rights Pulse*, 20 qershor 2020, <https://www.humanrightspulse.com/mastercontentblog/a-tsunami-of-hate-the-covid-19-hate-speech-pandemic>.

- Nëse personeli i sigurisë përballet me vështirësi praktike, p.sh. aksesin në pajisje mbrojtëse personale, shërbime shëndetësore, ushqime, kujdes për fëmijën, etj.;<sup>41</sup>
- Nëse personeli i sigurisë përballet me rreziqet specifike apo rreziqe që lindin nga formimi i një grupi pakice, p.sh. trajtimi i ushtarëve shtatzëna gjatë emergjencës së COVID-19 ose rreziku i incidenteve të urrejtjes ndaj ushtarëve që u përkasin grupeve fetare apo etnike, për shkak të shënjestrimit të tyre në median sociale;
- Nëse procedurat e zakonshme disiplinore janë pezulluar ose zëvendësuar. Nëse po, verifikohet nëse masat alternative përbushin detyrimet e të drejtave të njeriut, në përputhje me derogimet e shtetit nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>42</sup> ose nga traktate të tjera të të drejtave të njeriut, nëse ka: dhe
- Nëse procedurat normale për anëtarët e shërbimeve të sigurisë për të ngritur shqetësime dhe për të paraqitur ankesa duhet të rishikohen në kontekstin e emergjencës, përfshirë ankesat për ndryshimet në dislokimin e tyre dhe në zinxhirin e komandës, si dhe për shkeljet e të drejtave të njeriut apo rreziqe të tjera. Ky rishikim mban parasysh pengesat e njohura për denoncimin në kohë normale dhe pengesat e reja në kohë emergjence.

Kur vlerëson rreziqet ndaj të drejtave të njeriut për individët e sektorit të sigurisë, IKDNj-ja mban parasysh:

- Rishikimin e procedurave të propozuara të qeverisjes për të përcaktuar nëse personeli ushtarak po dislokohet me detyra që normalisht kryhen prej personelit civil, si dhe nëse ushtria i jep llogari zinxhirit civil të komandës;
- Nëse llogaridhënia dhe respektimi i shtetit të së drejtës nga ofruesit e sigurisë po ruhen në rrethanat e reja;
- Kur dislokohet ushtria, nëse mënyrat e dislokimit janë të përshtatshme për misionin, p.sh., cilat njësi po përdoren; me çfarë urdhrash, armësh dhe mjetesh; dhe nëse këto korrespondojnë me qëllimin e dislokimit;
- Çfarë arsyes janë dhënë për të vërtetuar se autoritetet civile kanë nevojë për ndihmë nga ushtria për të kryer misione civile;
- Nëse ndonjë zë i rëndësishëm si parlamenti ose media ka ngritur shqetësimin e abuzimit me shërbimet e sigurisë për qëllime politike ose qëllime të tjera nën mbulesën e krizës;
- Nëse buxheti i shërbimeve të sigurisë është rritur ndjeshëm pa shpjegim të shëndoshë, dhe nëse ka pasur një rritje proporcionale të buxhetit për mekanizmat e kontrollit dhe mbikëqyrjes;
- Nëse gjyqësori dhe organet e pavarura të ngarkuara me autorizimin e masave të veçanta të shërbimeve të sigurisë/ inteligjencës janë në gjendje të ushtrojnë funksionin e kontrollit në mënyrë efektive dhe të plotë, ose nëse ka pengesa në këtë drejtim, si p.sh. me aksesin në ambiente dhe informacionin e klasifikuar të shërbimeve të sigurisë;
- Nëse mekanizmat e kontrollit të brendshëm brenda institucioneve të ndryshme të sigurisë ende i dedikohen detyrave parësore, apo nëse janë modifikuar për të ndihmuar përpjekjet e ndihmës së parë;
- Nëse masat e reja të sigurisë kanë ndjeshmëri gjinore dhe mbrojnë të gjithë individët njësoj;
- Nëse përdorimi i teknologjive të avancuara nga sektori i sigurisë është i rregulluar mjaftueshëm me ligj; nëse operatorët janë trajnuar për përdorimin e tyre; dhe nëse janë të vetëdijshëm për kriteret, standardet dhe garancitë

<sup>41</sup> P.sh., gjatë pandemisë COVID-19, personeli ushtarak nuk u izoluan në shtëpi si shumica e qytetarëve, por vazhduan jetesën dhe punën në hapësira komunitare ku distancimi social është i vështirë; policia dhe personeli ushtarak u vunë në rrezik nga disa pjesëtarë të publikut që i pështynin apo kur ndihmonin punonjësit shëndetësore pa pajisje mbrojtëse personale adekuate.

<sup>42</sup> Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, "Udhëzimi për nenin 1 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: Derogimi në Kohë Emergjence", përditësuar më 31 dhjetor 2019, [Guide on Article 15 - Derogation in time of emergency \(coe.int\)](https://www.coe.int/en/governance/pdf-doctrine/15-derogation-in-time-of-emergency).

ligjore për përdorimin e softuerëve dhe harduerëve mbikëqyrës/monitorues, sidomos ato me qëllim të posaçëm që përdoren te popullata e gjerë;

- Si po menaxhohet kriza në ambientet e privimit të lirisë, cilat janë procedurat e emergjencës dhe si po zbatohen masat mbrojtëse në këto ambiente, përfshirë në qendrat e paraburgimit dhe burgjet; dhe
- Nëse civilët organizohen apo vetorganizohen për të ndihmuar profesionistët e sigurisë (mbrojtje civile, patrulla civile, vullnetarë policimi, etj.), si janë trajnuar, si u janë ngarkuar detyrat dhe si japin llogari për veprimet e tyre.

## **NDËRHYRJET PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT PAS KRYERJES SË VLERËSIMIT TË RREZIKUT**

Rezultatet e vlerësimit të rrezikut do të tregojnë llojin dhe kohën e çdo ndërhyrjeje. Lista më poshtë jep disa sugjerime pa qenë shteruese.

Ndërhyrjet gjatë konsolidimit të një emergjence mund të përfshijnë si më poshtë:

- Përhap informacion mbi masat e reja dhe efektet e tyre në të drejtat dhe përgjegjësitë përkatëse. Kjo duhet të përfshijë jo vetëm publikimin e vendimeve dhe udhëzimeve ekzekutiv (afishimi në faqen e internetit, në median sociale dhe përmes mjeteve të tjera të shpërndarjes), por edhe shpjegimin e këtyre teksteve (shpesh burokratike) në një gjuhë të thjeshtë;
- Ndihmon individët që të marrin informacionin e duhur dhe të kuptojnë natyrën dhe rëndësinë e masave, si edhe procedurat e ndryshuara për ushtrimin e disa të drejtave apo marrjen e shërbimeve;<sup>43</sup>
- Përgatit dhe shpërndan këshilla për publikun, përfshirë grupet vulnerabël dhe shoqërinë civile; edhe këshilla specifike mbi dhunën me bazë gjinore dhe krimin e urrejtjes, i cili mund të përfshijë nxitjen e denoncimeve nga palë të treta, si sinjalizuesit, si edhe ofrimin e informacionit mbi mekanizmat e raportimit konfidencial (nëse ka);
- Prodhon informacionin e mësipërm në gjuhët e shumicës dhe pakicave, sipas rastit, si dhe në formate praktike për të gjithë (për personat me aftësi të kufizuara të dëgjimit ose shikimit ose aftësi të kufizuara intelektuale);
- Verifikon informacionin dhe statistikën e publikuara nga qeveria për t'u siguruar që janë të sakta; ky verifikim u shton besueshmëri dhe rëndësi, nëse meriton, ose kërkon që publikut të gjerë t'i ofrohet informacion më i saktë;
- Rrit ndërgjegjësimin për rreziqet, vulnerabilitetet/dobësitë dhe shqetësimet brenda qeverisë, ofruesve të shërbimeve (në sektorët publik, privat dhe vullnetar) dhe publikut;
- I kujton qeverisë dhe ofruesve të shërbimeve që masat e përballimit të emergjencës të shihen nën optikën gjinore dhe, në veçanti, rrit ndërgjegjësimin për dhunën në familje;
- Verifikon (përmes bashkëpunimit, këshillave, mbikëqyrjes dhe presionit, qoftë publik apo jopublik) dhe sigurohet që të drejtat ekonomike dhe sociale të marrin mbrojtjen e duhur dhe, sipas rastit, të vendosën në qendër të masave shtetërore për përballimin e një kërcënimi joushtarak si në rastin e COVID-19;
- Rrit ndërgjegjësimin mbi rolin e IKDNj-së dhe si të kontaktojnë me të për mbrojtje dhe mbështetje;
- Ngre çdo shqetësim të identifikuar në këtë fazë pranë qeverisë dhe çdo grup këshillues ose drejtues të krijuar për të mbështetur qeverinë gjatë emergjencës dhe, në veçanti, këshillon për nevojën e balancimit të masave sipas parimeve të proporcionalitetit, nevojës dhe ligjshmërisë;

<sup>43</sup> Duhet pranuar se informacioni është i dobishëm kur është i plotë, i saktë, relevant dhe në kohë; që masat dhe udhëzimet që nxjerrin organet e menaxhimit të krizës mund të ndryshojnë shpejt; dhe që vendimi për përhapjen dhe shpjegimin e tyre, pasi merret, nuk është kortezi, por përgjegjësi që kërkon shumë burime njerëzore dhe TI.

- U ofron organeve vendimmarrëse kontribute të çmuara nga sektori publik dhe privat dhe nga palët e interesuara të shoqërisë civile. Kjo e forcon pjesëmarrjen dhe pluralizmin;
- Monitoron fushat e reja ku konstatohen shqetësime dhe harton rekomandime për veprim, p.sh., monitoron rastet e denoncuara të krimeve të urrejtjes dhe trendet e mediave sociale si pjesë e mbledhjes konstante të informacionit dhe analizës së të dhënave; dhe punon me autoritetet që të sigurohet se po merren masat e duhura për të mbrojtur njerëzit dhe lirinë e fjalës;
- Ngre padi ose mbështet paditë (brenda mandatit të IKDNj-së) kundër shkeljeve të të drejtave të njeriut;
- Monitoron se si qeveria përdor kompetencat e emergjencës për t'u siguruar se po respektohet legjislacioni për emergjencat. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar respektimit të parimeve të nevojës dhe proporcionalitetit, nëse kushtet për shpalljen e emergjencës nuk përmbajnë një afat përfundimtar apo rishikimin periodik të saj;
- Lidhur me dhunën me bazë gjinore, kërkon siguri që:
  - Personat që i largohen dhunës me bazë gjinore (përfshirë dhunën në familje) të përfshihen si përjashtim në legjislacionin e emergjencës që kufizon lëvizjen, ose të mos penalizohen për shkelje të kufizimeve të emergjencës;
  - Ky mesazh të shpërndahet gjerësisht me anë të medias tradicionale dhe sociale;
  - Pengesat për denoncimin të identifikohen;
  - Të eksplorohehen mënyra novatore për të mbushur boshllëqet që lënë kufizimet e emergjencës, si edhe për t'iu mundësuar personave pre e dhunës që të largohen dhe të denoncojnë;<sup>44</sup>
  - Kufizimet ligjore normale ndaj abuzuesve, përfshirë procedimin penal dhe ligjor, të vazhdojnë t'u ofrojnë mbrojtje personave të dëmtuar nga dhuna me bazë gjinore, ndërkohë që respektohen të drejtat e abuzuesit të dyshuar; dhe
  - T'u alokohen burime personave që trajtojnë këtë "pandemi hije", si pjesë e paketës së emergjencës.

Lidhur me sektorin e sigurisë, IKDNj-ja duhet të mbajë parasysh aspektet më poshtë:

- Verifikon për ndonjë zgjerim të panevojshëm të mandatit të forcave të sigurisë që u jep kompetenca shtesë, p.sh. për vënien në zbatim të masave të izolimit dhe reagon nëse është nevoja me masat më poshtë:
  - Kundërshton ndryshime të tilla normative në parlament, duke dhënë opinione dhe projektdryshime në ligje;<sup>45</sup>
  - Nëse parlamenti rrezon një opinion negativ apo projektdryshim normativ si më lart, e kundërshton aktin ligjor në gjykatën kushtetuese apo një autoritet analog;<sup>46</sup>
  - Kundërshton aktet nënligjore (p.sh. vendimet e qeverisë) qëllimi i të cilave arrihet edhe me ndryshime normative, si edhe i kundërshton ato në gjykatën kushtetuese apo një autoritet analog, nëse oponenca shpërfillet;
  - Diskuton problematikën dhe masat për veprim me OShC-të; dhe

<sup>44</sup> Për më shumë informacion mbi masat që janë marrë në rajonin e OSBE-së kundër dhunës, shih: ODIHR, "Zotimet për Dimensionin Njerëzor të OSBE-së dhe Reagimet e Shteteve ndaj Pandemisë Covid-19", *op. cit.*, shënimi 6, fq. 139.

<sup>45</sup> E zbatueshme për IKDNj-të që janë këtë kompetencë në mandatin e tyre.

<sup>46</sup> Në vendet që i kanë ngarkuar funksionon e kontrollit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë një tjetër institucioni (pra, që nuk kanë Gjykatë Kushtetuese si p.sh. Mbretëria e Bashkuar).

- Informon publikun për të gjitha aktivitetet më lart;
- Promovon transparencën për buxhetin, qeverisjen dhe çështjet e llogaridhënies, me çdo mënyrë të përshtatshme dhe brenda mandatit të vet;
- Konteston përdorimin e teknologjive që cenojnë jetën private pa bazën e duhur ligjore, ofron informacion të mjaftueshëm për të gjithë individëve dhe promovon masa mbrojtëse efektive kundër abuzimit të tillë;
- Intensifikon mbikëqyrjen e shërbimeve të brendshme të inteligjencës, sidomos nëse gjyqësori nuk është plotësisht funksional;
- Monitoron hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për përdorimin e aplikacioneve të gjurmimit dhe/ose kontaktimit (përfshirë në celular), si dhe monitoron se si informacioni dhe të dhënat personale të nevojshme për zbatimin e masave të emergjencës mblidhen, përdoren, mbrohen, shkëmbehen dhe asgjësohen;<sup>47</sup>
- Këmbëngul që çdo aplikacion gjurmimi dhe/ose kontaktimi në celular të zhvillohet në mënyrë të përgjegjshme: të jenë shkruar në një kod me burim të hapur, të përdoren në baza vullnetare dhe gjithmonë në interes të publikut, të përmbajnë vetëm opsionet rreptësisht të nevojshme, të mbahen nga personel i kualifikuar, të përfshijnë mbrojtje mbi informacionin mbi infektimin e një individi dhe të garantojnë saktësinë e këtij informacioni. Nuk duhet të përfshijë gjurmimin e vendndodhjes së përdoruesve individualë;
- Monitoron shkallën e krimit dhe abuzimit ndaj grave, fëmijëve, LGBTI, refugjatëve dhe grupeve të tjera vulnerabël, si dhe reagon nëse përgjigja e agjencive ligjzbatuese nuk është e përshtatshme me shkallën e kërcënimit që shkakton emergjenca, apo për ndonjë arsye tjetër;
- Siguron që aktivitetet e mbrojtësve të të drejtave të njeriut të mos kufizohen në mënyrë joproporcionale;
- Monitoron dislokimin e forcave të sigurisë dhe sjelljen e tyre me individët në rrugë dhe vende të tjera publike, si p.sh. në grumbullime (paqësore) apo ndërhyrje të tjera të sigurisë, duke ndërhyrë me qëllim parandalimi apo duke nisur hetime mbi veprimet e diskutueshme;
- Verifikon nëse njësitë ushtarake, kur mobilizohen, po përdorin armë zjarri dhe pajisje të papërshtatshme për detyrën që do t'i takonte një autoriteti civil për ta realizuar. Po kështu, heton mbi nevojën dhe proporcionalitetin e përdorimit të agjentëve kimikë (gazit lotsjellës), plumbave të manovrës, neutralizues me korrent, qen të stërvitur posaçërisht dhe mjete të tjera të posaçme për shpërndarjen e njerëzve apo për qëllime të tjera;
- Monitoron nëse të gjitha forcat e sigurisë (përfshirë kompanitë private) respektojnë standardet ndërkombëtare për përdorimin e forcës;
- Verifikon që efektivet e agjencive ligjzbatuese të jenë gjithmonë të identifikueshëm dhe llogaridhënës.<sup>48</sup> Kjo do të thotë se nëse efektivet mbajnë maska, helmeta apo mbulime të tjera për kokën (për shkak të masave shëndetësore apo rrethanave të tjera përjashtimore), sidomos kur ndalojnë persona, përdorin forcë fizike, ushtrojnë kontroll turme apo aktivitete të tjera, duhet të ketë masa të përshtatshme që garantojnë se efektivet në fjalë janë të

<sup>47</sup> Për më shumë informacion, shih: Bordi Evropian për Mbrojtjen e Të Dhënave, "Udhëzime 04/2020 për Përdorimin e Të Dhënave të Vendndodhjes dhe Mjeteve të Gjurmimit të Kontakteve në Kontekstin e Pandemisë COVID-19", 21 prill 2020, [https://edpb.europa.eu/our-work-tools/our-documents/linee-guida/guidelines-042020-use-location-data-and-contact-tracing\\_en](https://edpb.europa.eu/our-work-tools/our-documents/linee-guida/guidelines-042020-use-location-data-and-contact-tracing_en).

<sup>48</sup> Shih: OHCHR, "Parimet Bazë për Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Efektivët Ligjzbatues", 27 gusht 1990, parimi 10, <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/useofforceandfirearms.aspx>; shih edhe, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, "Kodi i Sjelljes për Efektivët Ligjzbatues", 17 dhjetor 1979, preambula, pika 8(a), <https://digitallibrary.un.org/record/10639?ln=en#record-files-collapse-header>.



identifikueshëm dhe mbajnë përgjegjësi personale për veprimet e tyre (p.sh. duke mbajtur një numër identifikimi në uniformë apo pajisje, që është lehtësisht i dallueshëm);<sup>49</sup>

- Verifikon që personeli ushtarak, nëse angazhohet në menaxhimin e krizës duke ndihmuar policinë dhe autoritetet civile në rrugë, të ketë rregulla të qarta dhe të përshtatshme për ndërhyrjet, të jetë i trajnuar për detyrat e ngarkuara dhe të jetë nën komandën civile dhe/ose koordinimin civil;
- Verifikon që policia dhe forcat e armatosura të mos përdoren për të vënë në shënjestër një komunitet të stigmatizuar (p.sh., romët dhe sintit), me pretekstin e emergjencës apo të sigurisë publike;
- Sigurohet që policia të mos përdorë masat e emergjencës për të kufizuar lirinë e shprehjes në mënyrë arbitrare;
- Heton çdo informacion apo ankesë lidhur me torturën;
- Verifikon që, gjatë epidemisë apo pandemisë, transporti i individëve të privuar nga liria të kryhet nën masa mbrojtëse kundër infektimit;
- Në rast emergjence të shkaktuar nga përhapja e një sëmundjeje ngjitëse, verifikon nëse efektivet e policisë që kryejnë ndalime, verifikime apo masa të tjera që kërkojnë kontakt të afërt, janë të pajisur me mjete mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së infektimit;
- Monitoron dhe heton çdo denoncim për abuzim në lëshimin e autorizimeve për lëvizje gjatë ndalimit të qarkullimit;
- Konteston çdo mangësi në procedurat e mbrojtjes së shëndetit dhe abuzimet në institucionet e privimit të lirë, përfshirë këtu mbështetjen apo ngritjen vetë të padive, sipas rastit;
- Monitoron situatën në ambientet e refugjatëve/emigrantëve/azilkërkuesve dhe si zbatohet regjimi i emergjencës në to (duke u siguruar që nuk ka diskriminim);
- Monitoron situatën në vendbanimet rome dhe sinti dhe si zbatohet regjimi i emergjencës në to (duke u siguruar që nuk ka diskriminim);
- Në rast ndalim qarkullimi, sigurohet që të ketë strehim efektiv për të pastrehët dhe të mos ndëshkohen për qëndrimin në ambientet publike derisa ky strehim të garantohet;
- Monitoron situatën në qendra të mëdha të kujdesit dhe mbrojtjes shëndetësore, si p.sh. spitalet e posaçme kundër COVID-19, dhe si zbatohet në to disiplina, siguria dhe masat mbrojtëse;
- Monitoron çdo rast apo përhapje në radhët e ushtrisë apo policisë të ndonjë ideologjie që toleron dhunën, duke reaguuar fuqishëm në çdo rast që evidentohet; dhe
- Kundërshton publikisht tendencat drejt militarizimit dhe sigurizimit (pranisë së tepërt të forcave të sigurisë) në shoqëri dhe hapësira publike si rezultat i emergjencës civile.

Lidhur me të drejtat dhe mirëqenien e personelit të sektorit të sigurisë, IKDNj-ja mban parasysh këto masa:

<sup>49</sup> Shih: Këshilli i Evropës, "Raport për Qeverinë Estoneze mbi Vizitën në Estoni të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Ndëshkimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës (CPT)", 19 prill 2011, pika 15, <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680695768>.

- Monitoron rolin dhe trajtimin e personelit të sigurisë gjatë krizës (duke pasur parasysh sa të vështirë e kanë të ngrenë problematika edhe në rrethana normale). Kur personeli i sigurisë (ushtarak apo civil) përjashtohet nga masat kufizuese të emergjencës, monitoron sigurinë dhe mirëqenien e tyre, përfshirë masat për mbrojtjen e tyre;
- Konsultohet me shoqatat profesionale të personelit të sigurisë ose forcave të armatosura (kur ekzistojnë), drejtuesit e qeverisë dhe të shërbimeve, mbi rreziqet e identifikuar, masat e qeverisjes dhe standardet e pranueshme të kujdesit në një kontekst emergjence;
- Shpërndan informacion te personeli i sigurisë mbi standardet e kujdesit, të drejtat e tyre dhe si të kontaktojnë me IKDNj-në gjatë emergjencës. Informacioni duhet të përmbajë referenca specifike për dhunën me bazë gjinore dhe krimin e urrejtjes; dhe
- Harton memorandum mirëkuptimi me palët kryesore, nëse është e përshtatshme, për të zyrtarizuar procedurën për personelin e sigurisë që të kontaktojë me IKDNj-në gjatë emergjencës. Në këtë drejtim:
  - Përfshin të drejtën për të kontaktuar IKDNj-në në rast refuzimi për të zbatuar urdhra të paligjshëm apo joproporcionale, si edhe për masat e zinxhirit të komandës në terren në rrethana të tilla;
  - Siguron mbrojtje të posaçme për sinjalizuesit; dhe
  - Përfshin masa pas ankesave nga individët për sjelljen e personelit të sigurisë gjatë emergjencës, si edhe për abuzim të pretenduar me kompetencat apo masa të paligjshme ose joproporcionale në vënien në zbatim të legjislacionit për emergjencën dhe kufizimet.

### 2.3. ZBUTJA, TRANCIZIONI DHE PERIUDHA PAS EMERGJENCËS

Pasojat e çdo gjendjeje emergjence kanë të ngjarë të zgjasin përtej krizës së menjëhershme. Sa më e gjatë kriza dhe sa më shumë që masat e qeverisë ndikojnë dhe prishin normalitetin e jetës dhe lirisë, aq më të rënda mund të jenë pasojat.

Kufizimet ose ndryshimet në kuadrin ligjor në dëm të gëzimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore mund të priren të jenë në fuqi edhe pas emergjencës, duke zgjatur kështu ekzistencën e saj dhe duke e degraduar përfundimisht nivelin e arritur të të drejtave dhe lirive.

Nga fundi i afatit të shpallur të emergjencës (ose teksa kriza e menjëhershme duket se po zbutet), qeveritë fillojnë të hartojnë propozime për daljen nga gjendja e emergjencës. Propozime të tilla mund të përfshijnë masa të reja që paraqesin rreziqe për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të publikut të gjerë, ose të grupeve vulnerabël specifike.

Në rastin e pandemive, shqetësimet përfshijnë masa të tilla si vazhdimi i karantinës së diferencuar, p.sh., për grupet veçanërisht vulnerabël si të moshuarit ose ata me probleme shëndetësore, apo kthimi i diferencuar në punë (me rrezikun e humbjes së vendit të punës apo uljes në detyrë) për ata që vlerësohen vulnerabël si punonjëset shtatzëna apo pjesëtarët e pakicave etnike.

Kriza ekonomike dhe sociale pas pandemisë mund të jetë e rëndë. Në këtë rast, IKDNj-të duhet të jenë të përgatitura të përballen me situata ku kriza ekonomike ka efekt të madh në jetën e qytetarëve. Masat në përgjigje të emergjencës mund të kenë thëlluar disa rutina disavantazhesh dhe pabarazish ekzistuese. Meqenëse këto rutina mund të kenë qenë të fshehura para pandemisë, ekziston rreziku që të anashkalohej përkeqësimi i kushteve të këtyre grupeve vulnerabël. Kriza sociale, ekonomike dhe politike pas emergjencës mund të krijojë situata të reja vulerabiliteti.

Kriza pas emergjencës mund të kenë ndikim të madh edhe te funksionimi i shtetit. Pasiguria mund të rritet nëse shteti nuk arrin shpejt rezultate konkrete; rrethana të tilla mund të krijojnë terren pjellor për ideologji antidemokratike.

Me zbutjen e gjendjes së emergjencës (por që kriza mund të ndizet sërish dhe kufizimet të rivendosen), IKDNj-të do të vazhdojnë shumicën e aktiviteteve edhe përgjatë fazës tranzitore.

IKDNj-ja mund të jetë vlerë e shtuar për këtë fazë të tretë pasi mbaron gjendja e emergjencës, duke përdorur dy mjete:

- Kryen një inventar strategjik të situatës; dhe
- Përgatit dhe përditëson rregullisht një udhëzues *online*, që mban publikun të informuar mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë periudhës së pasigurisë.

Të dyja masat synojnë të nxisin besimin dhe qetësinë e publikut, si edhe të garantojnë që masat e qeverisë të mos kapërcejnë vizën e kuqe të ligjit.

## INVENTARI I IKDNJ-së

Faza e tretë e emergjence mund të sjellë detyra shtesë për IKDNj-në për disa arsye. Për shembull, çdo konsensus kombëtar mbi kufizimet mund të fillojë të venitet teksa kërcënimet e menjëhershëm zvogëlohet dhe ndikimet e dëmshme të kufizimeve të emergjencës ndihen dhe kuptohen.<sup>50</sup> Brishtësitë në strukturat shoqërore, ekonomike ose demokratike mund të jenë ekspozuar ose përkeqësuar nga emergjenca. Inventari si një rishikim i masave të zbatuara është i dobishëm për tri arsye: Së pari, i mundëson IKDNj-të të vlerësojë nëse nevojiten ndërhyrje strategjike, për shembull, duke sfiduar ndonjë element të strategjisë qeveritare për daljen nga kriza që bie ndesh me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore; gjithashtu, u mundëson IKDNj-ve të bëjnë plane strategjike për punën e tyre në vijim; dhe, së fundmi, inventari përgatit IKDNj-të për të kontribuar thellësisht në çdo vlerësim të qeverisë apo të pavarur për përballimin e emergjencës dhe për hartimin e planeve kombëtare të përmirësuar për përballimin e çdo krize në të ardhmen. Për shembull, një mësim kryesor që evidentuan qeveritë gjatë pandemisë COVID-19 ishte nevoja për të përfshirë masa për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje gjatë izolimit të detyruar.<sup>51</sup> IKDNj-të kanë rol për të luajtur që dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje të jenë automatikisht çështje thelbësore në çdo plan emergjence të qeverive në të ardhmen.

Gjatë kësaj periudhe tranzicioni dhe pasigurie, ekziston nevoja jetike që të përdoren të gjitha kanalet në dispozicion për të rritur dialogun dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, ose për t'i ngritur nëse nuk ekzistojnë, në mënyrë që të reflektohen pikëpamjet e shoqërisë civile gjatë formulimit të politikave për masat e emergjencave dhe post-emergjencave. Informacioni i mbledhur përmes këtyre kanaleve e informon procesin e inventarit dhe duhet të përmbajë:

- Vlerësimet e ndikimeve sistematike që politikave ekonomike dhe buxhetet e miratuara për shkak të emergjencës kanë pasur të drejtat e njeriut dhe pabarazia. Vlerësime të tilla duhet të matin ndikimet aktuale dhe të ardhshme që kanë masat dhe buxhetet e emergjencës të gëzimi i lirive;
- Informacion për shenjat e një krize të re, që lidhet drejtpërdrejtë apo është pasoja e gjendjes së emergjencës fillestare;
- Vlerësimin e besimit dhe mbështetjes së publikut për qeverinë dhe strukturat demokratike;
- Vlerësimin e rreziqeve që lindin nga vazhdimi i kufizimeve të emergjencës (apo vendosja e kufizimeve të reja), si edhe nga çdo strategji që pritet të propozohet për kthimin në normalitet;
- Shqyrtim të veprimeve të IKDNj-së dhe kërkesave në vijim, bashkë me një vlerësim për mjaftueshmërinë e personelit dhe burimeve të tjera; dhe
- Identifikimin e çdo mësimi të nxjerrë për përmirësimin e masave të qeverisë dhe/ose punës (performancës) së IKDNj-së në fazën vijuese të emergjencës aktuale, ose gjatë gjendjeve së emergjencës në të ardhmen.

Për inventarin, kryerja paraprakisht e një vlerësimi krahasues mbi nivelin e mbrojtjes (normative dhe në praktikë) së të drejtave të njeriut dhe liritë themelore para dhe pas emergjencës do të siguronte informacion të çmuar që mund të përbëjë bazën për argumente solide për politikave.

Disa aspekte specifike që duhen konsideruar gjatë vlerësimit janë shtimi i mundshëm i ankesave dhe llojeve të tjera të kontakteve ose veprimeve, pasi njerëzit i kthehen jetës publike. Këto mund të përfshijnë problematika të lindura gjatë emergjencës, probleme me strategjinë e daljes nga kriza/tranzicionit (p.sh., vijimi i kufizimeve ndaj të drejtës për jetë familjare, si. p.sh. ndalimi i dasmave, ose kufizime më të gjata sesa është e nevojshme) ose probleme që vijnë nga përqendrimi i vëmendjes dhe i burimeve kombëtare në përballimin e emergjencës.

<sup>50</sup> Kombet e Bashkuara, "COVID-19 dhe Të Drejtat e Njeriut: Ne e Përballojmë së Bashku", *op. cit.*, shënimi 18, fq. 16.

<sup>51</sup> ODIHR, "Zotimet për Dimensionin Njerëzor të OSBE-së dhe Reagimet e Shteteve ndaj Pandemisë së Covid-19", *op. cit.*, shënimi 6.

Në përpjekje për të kufizuar dëmin e shkaktuar nga emergjenca, qeveritë mund të kenë ndërmarrë veprime që normalisht nuk janë në përputhje me detyrimet e të drejtave të njeriut, p.sh., dëbimi i emigrantëve ose shtetasve të huaj nevojtarë pa proces të rregullt, regjistrim i detyruar i aktivitetit bujqësor apo pune tjetër si kusht për sigurimet shoqërore - që të ulë barrën mbi burimet publike dhe jo sepse këto pune nevojiten për të prodhuar artikuj ushqimorë gjatë emergjencës - apo shtyrjen e zgjedhjeve për arsye politike.

Mund të konstatohen edhe kërcënime ndaj pavarësisë së IKDNj-së nëse perceptohet se nuk ka mbështetur plotësisht masat e qeverisë gjatë emergjencës. Në këtë drejtim, bashkëpunimi me mekanizmat rajonalë dhe globalë që mbështesin punën e IKDNj-ve - siç janë ENNHRI, GANHRI, ODIHR, Këshilli i Evropës, UNHCHR, Qendra e Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë (DCAF) dhe të tjerë - si dhe me mediat kombëtare dhe ndërkombëtare dhe me OShC-të mund të jetë thelbësor për të mbrojtur me sukses një institucion. Parimet e Parisit dhe Vëzhgimet e Përgjithshme përkatëse,<sup>52</sup> si dhe Parimet e Beogradit 2012,<sup>53</sup> të cilat përcaktojnë marrëdhëniet midis IKDNj-ve dhe parlamenteve me qëllim forcimin dhe përshkrimin më të mirë të "bashkëpunimit efektiv" të përcaktuar në Parimet e Beogradit, sigurojnë bazë të fortë të standardeve ndërkombëtare për ruajtjen e mandateve të IKDNj-ve. Sidoqoftë, një IKDNj duhet së pari të mbrojë fuqimisht pozicionin e vet, duke përdorur si argumente themelore gjetjet e inventarit dhe informacionin për besimin e publikut të IKDNj-ja.

Në këtë kuadër, IKDNj-të duhet të intensifikojnë ndërhyrjet publike për të ndërtuar lidhje më të forta me publikun, për të gjetur mënyra bindëse për të nxjerrë në pah pengesat, shqetësimet dhe sfidat me të cilat përballen individët dhe grupet në realizimin e të drejtave të tyre, dhe për t'iu dhënë ndihmë praktike për organeve shtetërore, duke dhënë edhe rekomandime dhe ekspertizë se si të përmirësohet performanca në këtë drejtim. Me fjalë të tjera, IKDNj-ja duhet:

- Të gjejnë mënyra për të arritur te publiku që të zbulojnë me çfarë problemesh po përballen njerëzit;
- T'u a bëjë të lehtë qytetarëve dhe t'i nxitë që të kontaktojnë IKDNj-në dhe të japë informacion;
- Të trajtojnë çdo pengesë procedurale që mund të pengojë individët të kontaktojnë me IKDNj-në për të kërkuar ndihmë; dhe
- Të identifikojnë dhe të zbatojnë zgjidhjet që trajtojnë shkakun e problemit.

## **BOSHTLLËQET NË INFORMIM QË DUHEN MBUSHUR: UDHËZUES PËR TË DREJTAT GJATË EMERGJENCËS / KRIZËS SOCIALE**

Gjendja e emergjencës pasohet nga një periudhë tranzicioni dhe, me shumë gjasa, lloje të tjera krizash. Pandemia COVID-19 është shembulli i një krize jo vetëm shëndetësore, sepse mund të çojë në kriza të mëdha ekonomike, sociale dhe madje edhe humanitare, që kërkojnë veprim nga ana e IKDNj-së.

Për të siguruar gëzim efektiv dhe të barabartë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në këto kohë pasigurie, IKDNj-ja duhet të bëjë çmos për të ndihmuar të gjithë individët brenda juridiksionit të vet që të dinë të drejtat dhe privilegjet e tyre. Ata duhet të bëjnë çmos që qeveritë t'u japin në kohë reale akses IKDNj-ve në informacionin e nevojshëm për të siguruar mbikëqyrjen publike të përgjigjeve ndaj krizave.

Individët më të prekshëm në shoqëri janë ata me më pak akses në institucionet dhe shërbimet që ofrojnë e mjete juridike në raste emergjencash civile. Përparësi duhet të ketë shpërndarja e drejtë e mbështetjes dhe barrës financiare për nismat që mbrojnë personat më vulnerabël. Nëse njerëzit nuk mund të vijnë tek ata, ata duhet t'u drejtohen njerëzve. IKDNj-të duhet të bëjnë çmos që të diktojnë të padiktueshmen. Nëse njerëzit nuk shkojnë dot te ato, duhet ato të arrijnë te njerëzit.

<sup>52</sup> Komiteti Ndërkombëtar Koordinues i Institucioneve Kombëtare për Promovimin dhe Mbrojtjen e Të Drejtave të Njeriut, "ICC SCA Vëzhgimet e Përgjithshme të miratuara në Gjenevë në maj 2013, [ICC SCA General Observations.pdf \(ohchr.org\)](https://www.ohchr.org/en/docd/123456789).

<sup>53</sup> Shih: "Parimet e Beogradit për Marrëdhënien Ndërmjet Institucioneve Kombëtare për Të Drejtat e Njeriut dhe Parlamenteve", 22-23 shkurt 2012, <https://www.forum-asia.org/uploads/wp/2017/01/Belgrade-Principles-Final.pdf>.

Legjislacioni i ri miratohet në forma të ndryshme si rezultat i rrethanave të emergjencës të cilat ligjvënësit nuk janë në pozita për t'i parashikuar. Kjo pasiguri juridike gjatë kësaj periudhe kërkon që IKDNj-të të ndjekin një qasje dydimensionale: nga njëra anë, informojnë publikun dhe veçanërisht grupet e marxhinalizuara dhe vulnerabël duke intensifikuar mesazhet që përcjellin dhe duke diversifikuar metodat e informimit dhe, nga ana tjetër, monitorojnë sistematikisht përputhshmërinë e legjislacionit të ri me standardet e shtetit të së drejtës.

## **UDHËZUES PËR TË DREJTAT GJATË EMERGJENCËS / KRIZËS SOCIALE**

Një mënyrë se si IKDNj-të mund ta realizojnë këtë është të përgatitin në bashkëpunim me të gjitha shërbimet shtetërore përkatëse dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile një "Udhëzues për Të Drejtat Gjatë Emergjencës/Krizës Sociale". Udhëzuesi duhet të përditësohet periodikisht që të reflektojë ndryshimet në legjislacion dhe kuadrin e gjerë normativ.

Informacioni duhet të jepet në mënyrë praktike dhe të aksesueshme nga të gjitha personat me aftësi të kufizuar, sidomos duke pasur parasysh personat që preken joproporcionalisht nga kriza/emergjenca ose masat pas emergjencës. Informacioni duhet të trajtojë të gjitha masat e zbatuara. Ky mjet mund të përdoret për të mbështetur punën e shërbimeve sociale, strukturave të vetëqeverisjes dhe përpjekje e tjera kolektive për të kontribuar në adresimin e nevojave të grupeve vulnerabël.

Përmbajtja e udhëzuesit mund të paraqitet e ndarë në tema, me data (fillohet me masat më të fundit dhe shkohet pas në kohë deri te masat më të hershme që janë ende në fuqi) dhe/ose sipas relevancës për shërbimin apo organin përgjegjës të cilin individët duhet ta kontraktojnë për të adresuar një problematikë.

Masat e identifikuar mund të përmbajnë ndryshime në legjislacion apo akte nënligjore për këto fusha:

- Tatimet – uljet e taksave dhe përjashtimet;
- Strehimi – kreditë dhe qiratë, si dhe masat për situatën e të pastrehëve; kodet e reja të ndërtimit dhe ulja e gjobave për ndërtimet pa leje për grupet vulnerabël; bonusi i qirasë dhe akomodimi;
- Punësimi dhe papunësia;
- Përfitimet sociale, përfshirë për të papunët afatgjatë dhe të sapofuturit në tregun e punës, pagë gatishmërie për pune, transporti publik falas ose i subvencionuar, asistencë sociale për kostot e strehimit dhe lehtësimi i mundshëm nga gjobat administrative;
- Shërbimet publike – tarifat sociale për lehtësimin e të varfërve dhe udhëzimet për heqjen e pezullimit të përfitimeve dhe shërbimeve;
- Përfitimet e aftësisë së kufizuar;
- Bursat (në para) shkollore apo bonuset familjare;
- Aksesin në qendrat e kujdesit ditor;
- Shërbimet mbështetëse për viktimat e dhunës me bazë gjinore, dhunën në familje dhe dhunën ndaj fëmijëve;
- Dispozita për persona të padokumentuar;
- Kujdesi shëndetësor, përfshirë shërbimet e shëndetit mendor dhe aksesin në mjekim dhe vaksinim;

- Masa ndihme më të gjerë për të adresuar krizën humanitare, p.sh. pensione për të moshuarit e pasiguruar apo rilidhje falas e energjisë elektrike; dhe
- Asistenca ligjore dhe ndihma juridike falas.

### 3. PËRFUNDIM

Gjendja e emergjencës është një gjendje e jashtëzakonshme dhe e përkohshme që shtetet e shpallin për t'i dhënë një përgjigje më efektive një kërcënimi të caktuar që sfidon seriozisht kapacitetet e shtetit për të mbrojtur jetën, sigurinë, lirinë dhe vlerat dhe të drejtat themelore. Roli i IKDNj-ve është të ndihmojnë shoqëritë në kapërcimin e këtyre kërcënimeve, duke dëmtuar sa më pak të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës – të cilat janë në qendër të mandatit të IKDNj-ve. Kërcënimi i jashtëzakonshëm që çon në gjendjen e emergjencës thëllon dhe ndërlikon më tej sfidat ndaj të drejtave të njeriut që ekzistojnë në një shoqëri. Kjo është arsyeja pse IKDNj-të duhet jo vetëm të vazhdojnë, por edhe të intensifikojnë përpjekjet në mbrojtje të të drejtave të njeriut, si gjatë ashtu edhe pas gjendjes së jashtëzakonshme. Nga këndvështrimi institucional, periudha pas emergjencës është po aq e rëndësishme sa vetë periudha e emergjencës, pasi pikërisht atëherë merren vendime madhore për mbajtjen apo modifikimin e masave të emergjencës. Për më tepër, pas emergjencës fillestare mund të ndodhë një emergjencë e dytë që mund të jetë krejt e re ose vazhdim i asaj fillestare.

Masat e marra gjatë gjendjes së emergjencës mund të kenë ndikime të ngjashme me efektet anësore të trajtimit të sëmundjeve. Gjatë luftës me kërcënime fillestare, gjendja e emergjencës mund të përshkallëzohet në mënyrë të tillë që të komprometojë vetë strukturën e demokracisë duke dëmtuar marrëdhëniet institucionale, sidomos sistemet e kontrollit dhe balancës. IKDNj-të janë organe mbikëqyrëse të pavarura me mandatin e bazuar në ligj dhe (zakonisht) në kushtetutat e vendeve respektive. Pozita e tyre e rëndësishme konfirmohet, forcohet dhe mbështetet nga standardet ndërkombëtare. IKDNj-të kanë jo vetëm kompetencën, por edhe detyrimin që të punojnë për të garantuar që ekzekutivi të jetë llogaridhënës edhe në kohëra të jashtëzakonshme. Rasti tipik është kur paralizohen disa format e tjera të mbikëqyrjes, siç është mbikëqyrja parlamentare.

Nëse periudha e emergjencës dhe pas emergjencës krijon ose ekspozon boshllëqe në arkitekturën institucionale që krijon kërcënime për individët, shoqërinë apo demokracinë, IKDNj-të duhet të veprojnë pa vonesa, brenda mandatit të tyre, që të evidentojnë dhe të ekspozojnë probleme të tilla strukturore dhe të ofrojnë propozime praktike për adresimin e tyre. Njëkohësisht, sado e rëndë të jetë situata, IKDNj-të nuk duhet të përpiqen të mbushin vetë këto boshllëqe duke vepruar përtej mandatit të tyre. Kjo do të kërcënonte disa prej vlerave demokratike themelore që mbrohen nga IKDNj-të dhe përbëjnë arsyen pse IKDNj-të ekzistojnë.

Kështu, IKDNj-të janë në pozitën ideale që të ngrënë zërin dhe jo thjesht të denoncojnë vendimet e pabazuara apo me baza të cunguara, por edhe të propozojnë procedura për përfshirjen dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje, sidomos në kohëra të turrjes së hapësirës demokratike.<sup>54</sup>

IKDNj-të mund të garantojnë që çdo zë, shqetësim dhe nevojë të dëgjohet, të merret parasysh dhe të adresohet në kohë emergjence. Teksa rrethi dhe fokusi i vendimmarrëse që përpiqen të përballojnë me efektivitet emergjencës ngushtohet, rreziku i marxhinalizimit të grupeve të pakicave dhe personave më vulnerabël të shoqërisë rritet. Edhe kur gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë në një shoqëri, ato zakonisht janë në pakicë në pozicionet e pushtetit dhe influencës. Sërish, emergjenca rrit rrezikun që ndikimet e saj te gratë dhe nevojat e tyre të posaçme të anashkalojnë apo të mos prioritizohen. Ky dokument nënvizon rolin e rëndësishëm udhëheqës të IKDNj-ve që të aplikojnë optike gjinore në të gjitha aspektet e punës së tyre. Gjithashtu, ofron shembull që tregojnë se si të mendosh jashtë rutinave të zakonshme mund të ndihmojë në identifikimin e nevojave të pakicave dhe grupeve vulnerabël të tjera.

<sup>54</sup> Për referencë, shih: GANHRI, "Deklarata e Marakeshit, "Zgjerimi i Hapësirës Qytetare dhe Promovimi dhe Mbrojtja e Aktivistëve të Të Drejtave të Njeriut, me Fokus të Veçantë të Gratë: Roli i Institucioneve Kombëtare për Të Drejtat e Njeriut", 10-12 tetor 2018, [https://nhri.ohchr.org/EN/ICC/InternationalConference/13IC/Background%20Information/Marrakech%20Declaration\\_EN\\_%2012102018%20-%20FINAL.pdf](https://nhri.ohchr.org/EN/ICC/InternationalConference/13IC/Background%20Information/Marrakech%20Declaration_EN_%2012102018%20-%20FINAL.pdf).

---

Ky mjet referimi thekson nevojën që IKDNj-të të intensifikojnë punën e tyre që të ndihmojnë në kapërcimin e krizës sa më shpejt dhe me sa më pak dëm të shoqëria dhe individët, si edhe të gëzimi i të drejtave të njeriut. Teksa IKDNj-të mbajnë këtë përgjegjësi vetë, ato duhet të synojnë që të ndajnë barrën e përgjithshme të krizës me institucionet e tjera demokratike dhe shoqërinë në përgjithësi. Kjo jo vetëm përforcon aftësinë përballuese, por rrit efektivitetin e tyre dhe forcon besimin te demokracia në një kohë kur ky besim mund të vihet në një sprovë shumë të vështirë.